

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7666 E diel 30 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës
Në zhvillimet e sotme globale evidentohet një problematikë komplekse e mprehtë, që afekton rëndë stabilitetin, sigurinë e paqen në shkallë ...
Vijon në faqen 21

Nga VASIL KURETA
Demokracia liberale përballë nacionalizmit dhe interesave imperiale


Opinion i Ditës
Për të shpjeguar në kohët e vjetra disa nga paradokset e Zenonit të Elesë u vunë në punë një grup i tërë dijetarësh. Paradoksi aq i thjeshtë në konceptim ishte ...
Vijon në faqen 22

Nga BEN ANDONI
SPAK, si miti i breshkës me Akilin!



“Vajza, mish për topat e luftës politike” Rama për policin Nuhu: Horr, nuk do të të ndahemi këmba-këmbës

Kryeministri: Arrestimet nuk i bën qeveria.
Reagon Lulzim Basha: Po amnistion kriminelët

Kryeministri Edi Rama apeloi drejtësi për Xhisela Malokun, vajzën e dhunuar nga Rexhep Rraja, djali i deputetit të Partisë Socialiste. Për herë të parë prej një javë kur kjo çështje po diskutohet, kryeministri Edi Rama komentoi nga Korça rastin e Xhisela Malokut, për të cilën shprehet se drejtësia duhet të bëjë punën e saj ...
Në faqet 4-5

EMILJANO NUHU U SHKRUAJTI EPROREVE QE NE 14 GUSHT: JA KUSH ME KERCONON OFICERI, "E-MAIL" PER KREUN E POLICISE: JAM NE RREZIK JETE

Dhunimi i Xhisela Malokut, efektivi në arrati: Më thanë ‘të zhdokim ty dhe familjen’.
Dëshmia e oficerit Çitozi: Vajza ishte me Rexhep Rrajën kur tërhoqi denoncimin



(Në foto) Emiljano Nuhu gjatë një interviste për "News 24". Xhisela Maloku. Faksimile e 'e-mail'-it, drejtuar eproreve të policisë
Në faqet 2-3



KERKESA
Meta në SHBA takon sekretarin e OKB: Shqipëria, anëtare e Këshillit të Sigurimit
Në faqen 6

RREZIKON BURG PERJETE
Masakrai gjyshen me 20 goditje thike, nipi në gjyq: Jam penduar
Në faqen 7

HISTORIA
Gjobë 90 mijë euro biznesmenit, lihet në qeli Lavdërim Tufa
Në faqen 8

PROVOKIMI FQINJ
Presidenti grek justifikon masakrat mbi çamët: Ishin "pro" nazistëve
Në faqen 6

LISTA EMERORE

Pronat, 8 mijë dosje me probleme. Regjistri që nga '93 deri në 2014
Në faqet 9-11

Historia e Rexh Metës dhe ndërhyrja e Rose Wilder Lane tek Enver Hoxha
Si shpëtoi pas luftës studenti shqiptar i Kembrixhit
Në brendësi: Muzika popullore dhe Aleksandër Peçi. "Iliada" e Ilia Ballaurit

NGA NDRËK GJINI
Rexh Meta (1906-1985), nga Rnjë banor i jetimorës së Shkodrës, bëhet shqiptari i parë që diplomohet me medalje të artë në Universitetin e Kembrixhit. Kjo falë fatit, aftësive të tij dhe shoqërimit që ai i bën gazetares amerikane më



të paguar në botë, gjatë periudhës së pas-Luftës së Parë Botërore, Rose Wilder Lane. Rexh Meta dënohet me vdekje nga Enver Hoxha. Por gazetaria, shkrimtarja dhe antropologja Rose Wilder Lane, sapo e mëson këtë fakt, ndërhyr gjër te Presidenti ...
Suplement

DOSJA "XHISELA MALOKU"

INTERVISTA

Intervista/ Emiljano Nuhu: I shkruajta drejtorit të policisë dhe ministrit

"E-maili" i oficerit të policisë për eprorët që në 14 gusht: Më kërcënojnë me jetë

"Jam babai i një vajze njëvjeçare. Deputeti Rraja u përplas me armë me policinë, u plagos ndaj mban syze"



Faksimile e "e-mail"-i Emiljano Nuhu, drejtor drejtorit të policisë dhe ministrit të Brendshëm

Nisida Tufa

Në një intervistë për emisionin "Kjo Javë" në "News 24", ish-oficeri Emiljano Nuhu, foli dje nga arratia pas deklaratave të SHCBA-së, në lidhje me rastin e Xhisela Malokut. Ish-oficeri Nuhu thotë se nuk i heq asnjë presje asaj ç'ka ka deklaruar në intervistën e tij të parë, ndërsa thotë se disponon fakte e prova, të cilat do i bëjë publike vetëm në gjykatë. Ndër të tjera, ish-oficeri akuzon institucionet përgjegjëse se po tentojnë të manipulojnë ngjarjen. Ai përsërit se është kërcënuar nga vëllai i deputetit Rrahman Rraja në prani të Taulant Ballës, që të mos merrte dëshminë të dhunuarës Xhisela Maloku.

Nisida Tufa: Do t'i marrim me radhë edhe ato, por unë dua të qëndroj të data 21 ju vetë si e provoni se keni qenë në komisarjat. A keni ju prova? Sepse çështja ka shkuar në gjykatë tani. Z.Balla ka bërë kallëzim penal ndaj jush dhe personave të tjerë. Ju vetë si e provoni se keni qenë në gjykatë.

Emiljano Nuhu: Unë kam prova për ta provuar, por vetëm në gjykatë do t'i dorëzoj këto prova që kam për ta provuar praninë e njerëzve që kam përmendur dhe që kanë qenë në komisarjat. Pavarësisht se institucionet po mundohen që t'i manipulojnë me të gjitha mundësitë dhe hallkat shtetërore që ato kanë.

Nisida Tufa: Ju e mohoni faktin që çështjen në fjalë e keni marrë më datë 27 korrik. Sepse në datën 21 ka qenë një tjetër oficer policie, i cili është pezulluar.

Emiljano Nuhu: Në datën 27 është bërë urdhri i delegimit për vazhdimin e hetimit nga ana ime. Më është deleguar dosja nga Prokuroria, kurse në datë 21 unë kam kryer veprimet që të deleguara me urdhër, por të deleguara me anë të telefonit, janë kryer veprimet hetimore. Dhe unë nuk kam



Ish-oficeri Emiljano Nuhu, dje në emisionin "Kjo Javë" në "News 24"

arritur t'i kryej këto veprime hetimore për shkak të kërcënimit që kam denoncuar. Që u kërcënova në zyrën time nga personat që unë kam përmendur dhe i përmend përsëri. Dhe ky ishte shkak që erdhi oficeri tjetër dhe vazhdoi veprimet hetimore të datës 21.

Nisida Tufa: Kur i keni kryer këto veprime, për të qenë më konkret?

Emiljano Nuhu: Të thash, në datën 21 veprimet e mia u ndërprejnë për shkak të ndërhyrjes së deputetit Rrahman

që kam bërë kallëzim në komisarjatin nr. 6.

Nisida Tufa: Z.Nuhu, në respekt të të gjithë atyre që janë të prirur për t'ju besuar për gjithçka që ju thoni, ju lutem a mund të jepni apo mund të shfaqni disa detaje rreth personave që kanë qenë në komisarjat në datën që ju pretendoni. Flasim këtu për deputetin Balla, për z.Bushi dhe persona të tjerë që keni përmendur. Mund të ndani me mua ndonjë detaj që ata vërtet kanë qenë në komisarjat, edhe pse provat

ni psikologjik që kam pasur në ato momente ishte shumë i madh dhe nuk më linte mundësi që i vetëm në zyrë të kapja detaje të shumta përballë 4-5 personave që kisha përballë.

Nisida Tufa: Çdo detaj që ju mund të thoni për bërë kriminologji, por edhe fakt për publikum që ndjek me shumë interes. A mbani mend si ishin veshur? Mbani mend ndonjë detaj tjetër, si u drejtuan, kush hyri i parë... Gjithçka që mund të na thoni?

Emiljano Nuhu: I pari mesa më kujtohet ka hyrë deputeti Rrahman Rraja, ka qenë i pari që ka hyrë në zyrë. Pastaj të tjerët me radhë. Dhe më agresiv nga të gjithë personat që kanë qenë brenda, ka qenë vëllai i deputetit Xhelal Rraja.

Nisida Tufa: Pse? **Emiljano Nuhu:** Ai ka qenë më agresiv, për shkak të veprimeve kriminale që ka kryer gjatë gjithë kohës dhe është persona me precedentë të theksuar kriminale, i dënuar për disa vepra penale. Njihet në të gjithë në zonë çfarë përfaqëson. Njihet nga strukturat e policisë, pavarësisht se nuk marrin guxim të shprehin. Ai person ka hyrë i armatosur në zyrën time me armë pa leje. Këtë e theksoj, ka qenë i armatosur me armë pa leje. Një person me 3-4 ve-

pra penale. Dua të theksoj se shtetasi Xhelal Rraja në 1997-1998 së bashku me vëllain e tij ka shkëmbyer zjarr me një punonjës policie të stacionit të policisë Fushë-Krujë dhe do të shpjegoj faktin tjetër që deputeti ka ngelur i plagosur në ato vite dhe prandaj qëndron gjithmonë me syze, edhe polici ka ngelur i plagosur. Këta përfaqësojnë njerëz intelektualë që janë brenda parlamentit të Shqipërisë. Janë njerëz me precedentë kriminale.

Nisida Tufa: Po mirë, z.Nuhu një person që hyri në komisarjat i armatosur për bërë rrezik apo jo? Pse nuk e bëtë të madhe që në ato momente? Pse reagoni shumë më pas? Pse nuk reaguat që aty? Pse nuk e kallëzuat? **Emiljano Nuhu:** Direkt

vetëm përpara dy njerëzve të parlamentit të Shqipërisë dhe një kryetari të bashkisë dhe grupet kriminale që ato mbështesin, çfarë mund të bëja unë i vetëm? Po të kisha kallëzuar këta që kallëzova nga BE, kur isha në Shqipëri, unë nuk do isha, nuk do ekzistojta më sot. Do isha...

Nisida Tufa: Z.Nuhu unë vijoj të theksoj që z.Balla moho kategori kësht që ka qenë në dt. 21 në komisarjat. Madje thotë që nuk ka qenë fare, ka qenë diku tjetër, duke peshkuar. Ju çfarë keni për të thënë në lidhje me këtë. Duke u qëndruar fort detajeve, çfarë kujtoni nga z.Balla se ju ka thënë atë ditë sipas pretendimeve tuaja?

Emiljano Nuhu: Dua të jap një shpjegim të vogël. Edhe

LARGIMI NGA SHQIPËRIA

H "Vendimin e kam marrë në datën 12 shtator, pasi mora një informacion që duan të më vrisnin dhe ky ishte vendimi që nuk mund të rrija dot më në atë vend".

pas castit që unë u kërcënova, sa gjeta mundësinë, reagoava duke kontaktuar me prokurorin e gatshëm dhe me drejtuesin tim të komisarjatisë. Në rrugë institucionale, këta persona për të zbatuar ligjin, drejtuesi im i komisarjatisë duhet të më kishte dërguar forca shtesë policie që unë të kisha mundësi që këta persona të ndaloheshin në ambientet e komisarjatisë dhe të fillonte procedimi penal ndaj tyre.

Nisida Tufa: Po ai ju ka kallëzuar apo jo, është i bindur në faktet dhe provat e tij që nuk ka qenë aty.

Emiljano Nuhu: Po mirë, ta vërtetojë që nuk ka qenë.

Nisida Tufa: Z.Nuhu, shtetasja Maloku është mirëpritur dhe trajtuar me përparësi nga policia, gjithmonë sipas deklaratave dhe reagimit të zv.drejtoreshës së policisë, e ndani këtë mendim me ne?

Emiljano Nuhu: Kam mendim krejt të kundërt. Ajo ka shkuar në disa komisarjate në kohë të ndryshme. Në komisarjatin nr. 3, në komisarjatin nr. 6 në komisarjatin e Krujës për të kallëzuar këto veprime ndaj atij shtetasi, por nuk janë marrë kallëzimet. Dhe e vetmja ditë kur është

MOHIMI I TAULANT BALLËS

H "Edhe mostra e Selenicës që vrau 8 persona në prani të të gjithë fshatit e mohoi si krim. Tha: 'Nuk i kam vrarë unë'. Edhe Balla do ta mohojë këtë krim".

Rraja, Taulant Ballës dhe kryetarit të bashkisë që më kërcënuan brenda në zyrën time. Nuk arrita dot të bëja më veprime dhe në datën 21, veprimet i kaluan oficerit Gentian Citozi. Unë kam vazhduar hetimet, pasi prokuroria mi delegoi me urdhër delegimi në datën 27, sepse asnjë oficer nuk i mori përsipër për t'i kryer ato hetime. Unë pranova t'i merrja përsipër për dhe në datën 30 u kërcënova përsëri,

1 keni lënë për një hap të dytë për në gjykatë.

Emiljano Nuhu: Ata kanë qenë në komisarjat dhe detaji që unë kam nga zyra ime janë fjalët e tyre që ata më kanë thënë me ironi, që janë shprehur nga deputeti Taulant Balla dhe Artur Bushi që, "hiqe pistoletën nga koka e oficerit se nuk i bën oficeri këto gabime" dhe kam qenë nën trysinë e armës së zjarrit brenda zyrës sime. Presio-



Paradite e paditi për përdhunim, në darkë u pendua. Misteri, a u kërcënua?

Oficeri Çitozi: Xhisela e tërhoqi padinë në prani të Rexhep Rrajës

Dy dëshmitë e policit para prokurorëve

marrë kallëzimi është në datën 21 në komisariatit nr. 3, pas shumë përpjekjeve të shtetas Xhisela Maloku. Dhe pas kësaj kohe, veprimet janë kryer, por ajo nuk është trajtuar mesa di unë me përparësi, siç e shpjegon drejtoresha.

Nisida Tufa: Z.Nuhu, unë dua t'i rikthem përsëri datën 21. Pasi ndodhi ajo që ju pretendoni, me kë folët për këtë gjë? Për deputetin Taulant Balla, për kërcënimin që keni marrë?

Emiljano Nuhu: Fola me drejtuesin tim të komisariatit dhe prokuroren e gatshme. Me këta dy persona kam komunikuar atë ditë. Më pas në datën 3 gusht kam vënë në dijeni drejtorin e përgjithshëm të policisë dhe ministrin e Brendshëm për problemin dhe në datën 14 përsëri e kam vënë në dijeni me 'email', por asnjë reagim nuk ndodhi nga këto institucione. Pse s'i përmend zvdrejtoresha në deklaratën e saj dy 'email'-et që unë i kam nisur drejtorit të përgjithshëm të policisë dhe ministrit të Brendshëm?

Nisida Tufa: Pra ky 'email' ekziston?

Emiljano Nuhu: 'Email'-i është nisur nga 'email'-i zyrtar i Policisë së Shtetit dhe ekziston.

Nisida Tufa: Janë dy 'email'-e tuaja?

Emiljano Nuhu: Po, ku unë i kam kërkuar ndihmë drejtorit të përgjithshëm për kërcënimin që më është bërë.

Nisida Tufa: Tek ky 'email' ju e përmendni deputetin Taulant Balla?

Emiljano Nuhu: Jo, nuk e përmend deputetin Taulant Balla në e-mail, për shkak të hakmarrjes që do bënin ata ndaj meje po ta kisha përmendur.

Nisida Tufa: Pra, ju emrin e deputetit socialist Taulant Balla për herë të parë e përmendni vetëm publikisht,

kur vendosët të flisni.

Emiljano Nuhu: Po nuk kisha guxim dhe besim t'i përmendja duke qenë në Shqipëri, për shkak të njerëzve që përfaqësojnë dhe fuqinë që kanë me pushtetin

Nisida Tufa: Po në 'email', cilët emra përmendët?

Emiljano Nuhu: Në 'email' i kam treguar rastin dhe kërcënimin që më është bërë nga shtetasit në datën 30 korrik 2018 dhe ngjarjen se si ka ndodhur me hollësi, çfarë përfaqësonin njerëzit që më kërcënuan dhe rrezikshmërinë e tyre. Dhe për shkak të këtij problemi, drejtori i përgjithshëm duhet minimalisht të më kishte thirrur dhe të më kishte pyetur si qëndron problemi dhe pastaj ta vlerësonte kisha nevojë unë për ndihmë, për mbështetje, për mbrojtje, ose s'kisha. Por drejtori i përgjithshëm as këtë gjë minimale nuk e bëri për të më pyetur si qëndron e vërteta.

Nisida Tufa: Pra, në vija të përgjithshme me aq sa kujtoni, çfarë përmbajtje kishte ky 'email'?

Emiljano Nuhu: Disa reshta nga ky email: 'Z. drejtor i përgjithshëm kërkoi mbështetjen tuaj, pasi unë në këtë vend ndihem i kërcënuar për shkak të dosjes hetimore që unë po vazhdoj hetimin dhe për shkak të kërcënimeve që më janë bërë në mënyrë të njëpasnjëshme nga shtetasit që kam përmendur. Dhe kërkoi të merrni masa në mënyrë ligjore për të më mbrojtur'.

Nisida Tufa: Po përgjigje a morët?

Emiljano Nuhu: Jo, nuk mora asnjë lloj përgjigjeje, as me 'email' zyrtar, as më mori njeri në telefon për të më pyetur si qëndron e vërteta. Një neglizhencë totale ndaj strukturave të Policisë së Shtetit, ndaj meje.

Mbrëmjen e 21 korrikut, Rexhep Rraja e shoqëroi Xhiselën në stacionin e policisë së Fushë-Krujës, të tërhiqte kallëzimin që ajo bëri ndaj tij për dhunë, mëngjesin e po asaj dite. Fakti tronditës, që të bën të dyshosh se 25-vjeçarja ka vepruar nën kërcënim, del në dritë nga dëshmitë që ish-nënkomisari Gentian Çitozi dha përpara Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Durrës, i cili u vu në lëvizje pas denoncimit të bërë nga Xhisela Maloku. "News 24" dhe "Balkanweb" disponojnë procesverbalet e marrjes në pyetje të Çitozit në datat 23 korrik dhe 3 gusht, në të cilat nënkomisari i pezulluar thotë se vajza u tërhoq me vullnetin e saj, por nuk jep shpjegime të qarta se përse i pranishëm në stacion ishte edhe ish-i dashuri i saj. "Rreth orës 14:00 jam njoftuar nga salla operative e Krujës, pasi kjo e fundit ishte lidhur me sallën operative të komisariatit nr.3 në Tiranë, nga e cila kishte marrë kallëzimin që Xhisela Maloku kishte paraqitur për shtetasin Rexhep Rraja, duke pretenduar se ishte përndjekur, dhunuar, sharë dhe ofenduar prej tij. Për rastin jam njoftuar unë nga salla, me qëllim që të verifikojta atë dhe të kryeva veprimet procedurale, të cilat do të ishin të nevojshme për hetimin. Kam njoftuar shtetasin Rexhep Rraja, i cili është paraqitur pranë stacionit të Policisë Fushë Krujë, rreth orës 20:00 i shoqëruar me kallëzuesen Xhisela Maloku, së bashku me dy avokatë dhe një psikologe. Me kërkësen e tyre kam përpiluar procesverbalin e heqjes dorë nga kallëzimi që kishte bërë pranë komisariatit të policisë nr.3 Tiranë".

DËSHMIA
Çitozi deklaroi se për të gjitha këto veprime ka komunikuar me shefin e stacionit, atë të Policisë Kriminale si dhe me shefin e Komisarariatit Krujë. Ai mohoi që nga ana e këtyre të fundit të ketë pasur presion apo kërkëse për të favorizuar të kallëzuarin Rexhep Rraja, djalin e deputetit të Partisë Socialiste, Rrahman Rraja. Qëndrim të ndryshëm nga Çitozi, i pezulluar nga detyra, mban ish-komisari Emiljano Nuhu. Ai pretendon se u kërcënua me armë në praninë e njerëzve të veshur me pushtet, me qëllim që të mos firmoste arretimin e djalit të deputetit.



Xhisela Maloku

"U dogji me cigare dhe ka shenja në shpatull e në kofshë"

Pas ekspertizës së mjekut, prokuroria merr në pyetje vajzën e dhunuar Xhisela Maloku

Xhisela Maloku, vajza e dhunuar është marrë dje në pyetje nga prokuroria pas daljes së akt-ekspertizës. Prokuroria ka vendosur të pyesë 25-vjeçarën, e cila dyshohet se është dhunuar nga djali i deputetit të Partisë Socialiste, Rrahman Rraja. Këtë vendim prokuroria e mori pasi administroi tabulatet telefonike të vajzës. Në dokumentin e ekspertëve mjeko-ligjorë thuhej se vajza ka shenja dhune në shpatull, ndërsa dëgjie me cigare në kofshë. "Dërrmishja në shpatullën e djathtë dhe ekimozat në pulpën dhe kërcërimin e majtë janë shkakuar me mjet prerës. Dërrmishjet e vërejtura në kofshën e djathtë janë shkakuar me mjet prerës. Dërrmishjet e vërejtura në kofshën e djathtë janë shkakuar nga veprimi i faktorëve termikë, siç mund të jetë edhe cigarrja". Dëmtimet e konstatuara në trupin e 25-vjeçarës, sipas ekspertëve të mjekësisë ligjore, hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të cilat sjellin si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punën në masën prej 9 ditësh. Xhisela Maloku rezultoi të jetë dhunuar me mjete të forta dhe ka shenja të dëgjies me cigare. Vajza e tërhoqi denoncimin dhe sipas ish-nënkomisarit Emiljano Nuhu, e bëri për shkak të presioneve. Megjithatë, dy muaj pas skandalit, ekspertët konfirmojnë faktin se Xhisela ka qenë objekt dhune. Në dokumentin thuhej se vajza ka shenja dhune në shpatull, ndërsa dëgjie me cigare në kofshë. Ekspertiza mjekoligjore i është vënë në dispozicion prokurorisë së Krujës pasditën e 27 shtatorit 2018 dhe është administruar në dosjen hetimore të Rexhep Rrahjas, i cili ishte nën hetim për përndjekje, ndonëse kallëzuesja ishte tërhoqur nga denoncimi. Pas njohtes me aktin, prokuroria ka fuar në pyetje nënën dhe motrën e 25-vjeçarës si dhe një mikeshë të saj. Burime të besuara pohojnë për "News 24" se nëna e Xhiselës mohoi të ketë pasur dijeni për problemet e së bijës, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe shoqja e saj. Ndërsa e motra ka pohuar për oficerët e policisë gjyqësore, se ishte në dijeni që Xhisela kishte debate me të dashurin e saj, por vetëm në një rast ka pasur zënkë mes tyre.



SI NISI HISTORIA?

Ish-nënkomisari Emiljano Nuhu dha një intervistë me gazetarin Basir Çollaku, ku pretendoi se është kërcënuar në ambientet e stacionit të policisë në Fushë-Krujës nga njerëzit e deputetit të PS, Rrahman Rraja dhe në prani të Taulant Ballës që të mos hetonin rreth dhunimit që Rexhep Rraja i bëri të dashurës së tij.

TRANSFERIMI

Pavarësisht 'email'-it që nënkomisari Nuhu bëri më 14 gusht, një ditë më vonë, më 15 gusht ai transferohet në Berat dhe jo në Tiranë, siç kishte kërkuar. Kjo situatë e ka detyruar atë të braktisë policinë dhe të largohet nga vendi.

REFIMI NE POLICI

Dëshmia e vajzës: Djali i deputetit më dogji me cigare

Xhisela Maloku, vajza e cila dyshohet të jetë përdhunuar nga djali i deputetit Rrahman Rraja, ka rrëfyer për dhunën që Rexhep Rraja ka ushtruar ndaj saj rreth 2 muaj më parë. Në dëshminë e dhënë në Komisarariatin e Policisë në Krujë para oficerit Emiljano Nuhu, më datë 30.07.2018, Maloku ka treguar arsyet pse ajo e ka tërhoqur herën e parë kallëzimin ndaj Rexhep-it. Sipas dëshmisë së saj, Xhisela tregon se është njohur me djalin e deputetit në vitin 2012 dhe ka qenë e lidhur me të deri në vitin 2017. 25-vjeçarja rrefën se pas ndarjes me djalin e deputetit të PS, kanë filluar konfliktet. Ajo tregon se kallëzimin në polici e ka bërë për ngjarjen e ndodhur më datë 19.07.2018, ku sipas saj është takuar me Rexhep Rrahjen dhe pas një debati me tone të ashpra në makinën e tij, nën kërcënimin e armës, ai e ka dërguar në një hotel. Në dhomë ajo tregon se është dhunuar nga djali i ish-deputetit të PS, është dëgjur me cigare në këmbë prej tij dhe është goditur në kokë me qytën e pistoletës. Si pasojë e dhunës së ushtruar, vajza thotë se ka humbur ndjenjat dhe nuk kujton më gjë.



Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit noterial kombëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhoma Kombëtare e Noterisë (DH.K.N.) Ikon Operatorit Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkundrejt pageses prej 10.000 leke, pranë Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri. Propozimet do të pranohen brenda datës 7 tetor 2018 ora 10:00 AM

SKANDALI REAGIMET

Kryeministri e quajti Nuhun "horr", kreu i PD: Sa herë kapet në krim, sulmon denoncuesit

Basha, akuza Ramës: Po amnistion përdhunuesin dhe kriminelët

"Turp! Vajza jetime u la pa mbrojtje"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se në vend që të mbrojë vajzën jetime të dhunuar nga djali i deputetit socialist, po amnistion përdhunuesin dhe kriminelët e grupit të tij parlamentar. Sipas Bashës, krimi shtetëror është projekt personal i Ramës. Ai i garantoi shoqiptarët se PD-ja do ta çmontojë nga rrënjët dhe politika do të pastrohet nga krimi". Me një status në "Twitter", Basha shkruan se Rama po vepron njësoj siç bëri me përdhunuesin Elvis Roshi dhe trafikantin e vajzave, Arben Ndoka. Lideri i PD-së thekson faktin se në vend që shteti të dalë në mbrojtje të vajzës së dhunuar, rasti i Xhiselës, Rama vijon planin kriminal, që sipas tij, është mbjellja e kriminit shtetëror dhe favorizimi i shkelësve të ligjit. "Edi Rama është i zhytur aq thellë në kalbësirën e kriminit dhe drogës të pushtetit, sa nuk ka më asnjë gram ndjeshmërie prindërore për një vajzë të përdhunuar dhe të torturuar nga banda e tij. Turp! Në vend që të mbrojë vajzën jetime, amnistion përdhunuesin dhe kriminelët e grupit të tij parlamentar, Taulant Balla dhe Rrahman Rraja, njësoj siç bëri me përdhunuesin Elvis Roshi dhe trafikantin e vajzave, Arben Ndoka. Krimi shtetëror është projekti personal i Ramës. Ne do ta çmontojmë nga rrënjët! Politika do të pastrohet nga krimi", tha z.Basha.

Një prej tyre është rasti i Dritan Zaganit, për të cilin Basha shprehet se zbuloi krimin e Saimir Tahirit, por u trajtua si kriminel nga Edi Rama. Po ashtu përmend edhe Emiliano Nuhun, që sipas Bashës zbuloi krimin e

Taulant Ballës dhe Rrahman Rrajës, por që sërish nga Rama u trajtua si kriminel. "Sa herë kapet në krim, Edi Rama mbron kriminelët dhe sulmon denoncuesit e kriminit", shkruan kreu i PD-së, Lulzim Basha.

AKUZA

"Në vend që të mbrojë vajzën jetime, amnistion përdhunuesin dhe kriminelët e grupit të tij parlamentar, Taulant Balla dhe Rrahman Rraja, njësoj siç bëri me përdhunuesin Elvis Roshi dhe trafikantin e vajzave, Arben Ndoka. Krimi shtetëror është projekti personal i Ramës. Ne do ta çmontojmë nga rrënjët! Politika do të pastrohet nga krimi", tha z.Basha.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

"Xhisela', kryeministri fryhet kot si derr"

Vasili: Luftën e bëjnë heronjtë, qeverisin maskarenjtë dhe përfitojnë horrat

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, iu përgjigj dje deklaratave të kryeministrin Rama, i cili sulmoi nënkomisarin Emiliano Nuhu. Vasili i kujton Ramës se luftën e bëjnë heronjtë, qeverisin maskarenjtë dhe përfitojnë horrat. "Heronjtë po denoncojnë krimin dhunës dhe trafikun e drogës. Maskarai që kryeqeveris, fle me kriminelët, zhvat pronën publike, mbush shkollat me drogë dhe mbron dhunuesit. Horrat përfitojnë para, mbrojtje dhe pushtet. Fati i kryemaskarenjve dhe i horrave është i paracaktuar: fund i tmerrshëm i tyre, pa kthim", shprehet z.Vasili. Më herët Vasili akuzoi Ramën se mbron dhunuesit. Deputeti i LSI shkruan: "Kryeministri me shumë frikë mezi belbëzoi ca fjalë për dhunimin e vajzës nga Fushë-Kruja". "Kryeministri fryhet kot si derr, mbron




dhunuesit dhe nuk heq dot asnjë prej tyre. Kryeministri me shumë frikë, mezi belbëzoi ca fjalë për dhunimin e vajzës nga Fushë-Kruja. Ka frikë dhe fryhet si derr sikur çdo thotë. Ka frikë se deputetëve dhunues, mbështetës të dhunës dhe fshehës të dhunës nuk ka çfarë u bën fare, u rruan bishtin. Ngaqë ka qenë dhunues vetë, nuk dënon dot të ngjashmit me veten. Sa për policinë, turpin



REAGIMI

"Heronjtë po denoncojnë krimin dhunës dhe trafikun e drogës. Maskarai që kryeqeveris fle me kriminelët, zhvat pronën publike, mbush shkollat me drogë dhe mbron dhunuesit. Horrat përfitojnë para, mbrojtje dhe pushtet. Fati i kryemaskarenjve dhe i horrave është i paracaktuar: fund i tmerrshëm i tyre, pa kthim", shprehet z.Vasili.

e saj nuk e lan as uji i oqeanit, pasi jo vetëm nuk e mori në mbrojtje vajzën e dhunuar, por dhe nxori dy gra police që flisnin pro dhunës së femrës, ky është fundi moral dhe shoqëror i kësaj policie. Mund të gjenin plot të paturp që mund të recitonin vjershat e Edi Ramës, por duhet t'i kishin kursyer ato dy gra nga ky rol i ndyrë në mbrojtje të dhunës ndaj një femre", shprehet z.Vasili.



Gjatë një seance parlamentare

Gratë deputete, në mbrojtje të Xhiselës

Protesta para Kryeministrit: Të reagojmë sot, se nesër do të jetë vonë!

Nën moton "Të reagojmë sot, se nesër do të jetë vonë" gratë përfaqësuese të shoqërisë civile u mbledhën dje përpara Kryeministrit si protestë në mbështetje të Xhisela Malokut, vajzës së dhunuar nga djali i deputetit socialist, Rrahman Rraja. Ata kërkuar që rasti i Xhiselës të mos kalojë në heshtje institucionale, por është koha për një reagim të fortë ndaj dhunës barbare. Protestës iu bashkuan dhe deputetet gra të opozitës, që akuzuan drejtpërdrejtë atë që e konsiderojnë mbështetje institucionale ndaj djalit të deputetit Rraja. Deputetja e PD, Dhurata Çupi, njëherësh sekretarja e Aleancës së Grave, u ka bërë apel kolegeve të shumicës. "Thërritimi ndjenjës njerëzore të mëmësisë dhe denonconi ngjarjen e paprecedentë. Kërkojmë që kryetari i Kuvendit, presidenti, kryeministri, ministri i Brendshëm, prokuroria dhe të gjitha institucionet të prononcohen, jo vetëm të distancohen, por të dënojnë me forcë këtë ngjarje. Ndaj djalit të deputetit, që është denoncur për dhunën nuk është marrë asnjë masë, kemi mosrregim nga Ministria e Brendshme dhe kreu i Policisë së Shtetit. Ndaj vajzës nuk është marrë asnjë masë mbrojtjeje. Duam të informohemi për çdo masë që do të merret për jetën dhe sigurinë për Xhiselën", - tha zj.Çupi. Kurse Oriola Pampuri deklaroi: "Dhuna ndaj Xhiselës hapi një plagë, e cila dhëmb njëllor për të gjitha ne këtu. Për të gjitha ju zonja, vajza dhe gra që na ndiqni dhëmb njëllor dhe është përdhunimi ndaj saj, në fakt është përdhunim i gjithë shoqërisë sonë". Kurse Klajda Gjoshka tha: "Ka të bëjë me dhunimin që i bëhet gjithë shoqërisë përmes bandave dhe vetë njerëzve".

"Xhisela", gratë e PS: Dënojmë dhunën dhe keqpërdorimin politik

Grupi i grave deputete të Partisë Socialiste reagoi me një deklaratë zyrtare për dhunën e ushtruar ndaj të resë Xhisela Maloku, e cila denoncoi djalin e deputetit të PS-së, Rrahman Rraja si dhunues, përdhunues dhe torturues. "Grupi i grave deputete të PS-së dënon çdo lloj forme dhune dhe mbështetë dhe inkurajon institucionet përkatëse në kryerjen deri në fund të të gjitha procedurave të nevojshme për nxjerrjen e përgjegjësive dhe ndëshkimin ligjor të përgjegjës për dhunën e ushtruar mbi vajzën Xh.M.", - thuhet në deklaratë. Deputetet e PS-së kanë një apel për koleget e tyre opozitare, të cilave u bëjnë thirrje "të ndikojnë në ndalimin e keqpërdorimit publik të vajzës për motive politike".



Kryeministri paralajmëron oficerin Nuhu: Nuk do i ndahemi këmba-këmbës atij horri

"Xhisiela", Rama: Askush mbi ligjin, sillni prova kundër deputetit Rraja

"Sulmi ndaj Ballës, qenëri e neveritshme"

Kryeministri Edi Rama apeloj drejtësi për Xhisiela Malokun, vajzën e dhunuar nga Rexhep Rraja, djali i deputetit të Partisë Socialiste. Për herë të parë prej një javë kur kjo çështje po diskutohet, kryeministri Edi Rama komentoj nga Korça rastin e Xhisiela Malokut, për të cilën shprehet se drejtësia duhet të bëjë punën e saj e t'i shkojë deri në fund çështjes. Por sipas tij, drejtësinë duhet ta bëjnë organet që u është besuar kjo detyrë. "Vajza meriton drejtësi. Transformimi i dramës së saj në një motiv lufte politike është rridhim publik i vajzës nga Partia Demokratike, mediat dhe analistët, që pa dashur t'ia dinë fare për vajzën, e kanë kthyer në mish për topat e luftës së tyre politike dhe mediaticë", shprehet Rama. Nënoficerin e policisë së Fushë-Krujës, Emiliano Nuhun e cilëson një horr, ndërsa këmbëngul se policia ka bërë detyrën e saj dhe se djali i deputetit socialist nuk ka pasur asnjë trajtim preferencial. "Një horr i kthyer në hero, në vend që të dënohej publikisht nga të gjithë si një person që ka braktisur detyrën, ka përdorur rastin për të marrë azil. Nuk do t'i ndahemi këmba këmbës atij horri. Për ne askush s'është mbi ligjin, jo djalë deputeti e deputet. Arrestimet nuk i bën qeveria, nuk i bën kryeministri", thekson kryeministri. Rama duket sikur merr në mbrojtje Taulant Ballën, kur sulmon dhe i sfidon të paraqesin prova të gjithë ata që e kanë përfshirë në këtë çështje, si Partinë Demokratike, ashtu dhe median. "U takon akuzuesve të provojnë nëse janë përfshirë apo jo deputetë të Partisë Socialiste në këtë çështje, duke e konsideruar sulmin ndaj Taulant Ballës dhe përfshirjen e mediave, qoftë edhe me indiferencë ndaj personit të tij, si një qenëri e neveritshme", shprehet Rama. Sa i takon deputetit Rraja, kryeministri tha sesa kohë nuk është provuar përfshirja në presionin e pretenduar, ai nuk mban përgjegjësi për të birin maxhoren. Në të



Kryeministri Edi Rama

PARALAJMËRIMI

Kryeministri informoi dje nga Korça se, "janë 462 raste masash disiplinore, paralajmërimesh për largime nga puna, apo dosje të referuara në prokurori, për të cilat hetimi administrativ ka nxjerrë përgjegjësi dhe ka rekomanduar masën përkatëse. Çdo qytetar - theksoj ai - ka fuqinë e pushtetit ekzekutiv, sepse ne e besojmë termin bashkëqeverisje".

kundërt, nëse hetimet do të dëshmonin pretendimet e nënoficerit Nuhu, Rama deklaroi se ndaj tij do të ndiqet e njëjta praktikë si për rastet të ngjashme kur përfaqësuesit e kësaj force kanë shkelur ligjin. Ai shprehet shqetësimin se vajza po përdoret nga disa media, apo analistë për qëllime politike dhe kjo siç tha Rama, është njësoj sikur të dhunohej për herë të dytë. "Deputeti duhet të hetohet njëjloj si të gjithë të tjerët, nëse ka apo jo implikim në këtë proces. Po heptojmë në një sistem, që

çdokush që mbush 18 vjeç përgjigjet vetë para ligjit, cilidho qoftë, dhe askush nuk mban përgjegjësi përveç atij. Çështja është e qartë, vajza meriton drejtësi dhe të gjithë të japin kontributin e tyre. Prokuroria duhet të çojë deri në fund hetimin dhe pastaj i takon gjykatës. Askush nuk është mbi ligjin, jo djalë deputeti, por të gjithë ne jemi të barabartë para ligjit. Këtë e kemi treguar gjithmonë. Kush do që të kuptojë, kupton. Është një variant subjektiv që nuk më intereson, më intereson varianti i prokurorisë dhe çdo variant i çdokujt tjetër që sjell prova për të kundërtën e asaj që duket nga ajo që ka publikuar policia. Nuk e gjykoj dhe konsideroj variantin e të atit të djalit. U takon akuzuesve që duhet të provojnë nëse janë përfshirë apo jo deputetë të PS. Policia e ka respektuar procedurën dhe unë ju sfidoj për të kundërtën, deklaroi z.Rama. Kryeministri mbro Ballën dhe e quan "qenëri e neveritshme" sulmin që po bëhet ndaj tij.

"Qeveri hajdute", Rama pritet me protesta në Korçë

Në Korçë kryeministri Edi Rama u prit me protesta nga Partia Demokratike. Protestuesit e akuzuan kryeministrin për varfërim të qytetarëve dhe lidhje me krimin. Ata mbanin në duar pankartat "Rama ik" gjatë kohës që kryeministri dhe ministrat po zhvillonin mbledhjen e qeverisë tek "Shtëpia e Flamurit". Policia kishte vendosur kordon policor për të ndaluar protestuesit që të afroreshin, ndërkohe që pati tensione në momentin kur ata tentuan të çinin kordonin e policisë dhe të afroreshin aty ku po mbahej mbledhja, por nuk janë lejuar. Në protestë ishin edhe deputetë të PD-së. Në një moment deputeti demokrat, Klevis Balliu u shpreh: "Për kë punoni për popullin, apo për banditit?". Dhe polici u përgjigj: "Për familjen".

"Xhisiela", Balla: U zbardh "Babale 2", Basha dhunon me inskenime

Taulant Balla, i akuzuar nga Emiliano Nuhu se ka qenë i pranishëm kur ish-oficeri është kërcënuar me armë brenda në komisariatin e Fushë-Krujës, thotë se hetimi administrativ i policisë vërtetoi se video-dëshmia e Nuhut, dhënë për një media lokale ishte inskenim i sajuar në zyrat e Partisë Demokratike. Duke iu referuar shkëlqeve të gjetura nga policia për nënkomsarin, Balla kërkon nga Lulzim Basha t'i japë fund përdorimit politik me këtë çështje. "Keqpërdorimi politik nga Lulzim Basha i kësaj ngjarjeje është i turpshëm, por edhe kriminal, në përpjekjen për të ndryshuar rrethanat dhe për të marrë në mbrojtje mikun e tij, Emiliano Nuhu. Zbardhja e Babale 2 kërkon që minimalisht Lulzim Basha të distancohet nga mikun e tij Emiliano Nuhu dhe PD të heqë dorë nga kjo lloj politike e ulët", u shpreh z.Balla. Balla megjithatë shprehet se ngjarja e dhunimit të vajzës është tronditëse dhe se drejtësinë për këtë çështje nuk e vendos politika. "Opinion publik është me të drejtë i tronditur sa herë që raste të tilla dhune ndodhin dhe pret që dhunuesit të ndëshkohet. Por jam i sigurt që opinionin publik e pret ndëshkimin nga drejtësia, aspak nga politika", deklaroi z.Balla. Kreu i grupit parlamentar socialist hodhi poshtë pretendimet e ish-oficerit Nuhu, duke thënë se në 21 korrik ka qenë i angazhuar me aktivitetet politike në rrethe.

"Kryeministri nuk përmendi fjalën 'ndëshkim'"

Berisha: Rama, përpjekje për të fshehur dhunën ndaj Xhiselës

Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha sulmoi djathtë kryeministrin Edi Rama se e shpalli Shqipërinë si shtetin e parë të mbrojtjes në botë. Berisha tha se pavarësisht përpjekjeve të Ramës dhe cubave të tij për të fshehur dhunën e ushtruar ndaj Xhisiela Malokut, ishte oficeri Emiliano Nuhu, i cili denoncoi dhe fakti këtë ngjarje për të gjithë shqiptarët. Berisha shkruan në 'FB' se Edi Rama iu doli në mbrojtje dhunuesve dhe përdhunuesve, duke treguar edhe njëherë se sa e pasigurt është jeta e shqiptarëve. "Kryepërdhunuesi foli vetëm sot(dje)për të



na faktuar se është ai vetë kryepërdhunuesi i këtij vendi, që tashmë do të quhet Vjollistan. Kështu, në reagimin e tij prej 42-fjalësh, kryepërdhunuesi foli duke marrë në mbrojtje shpurën e

tij kriminale të cubave dhe përdhunuesve, ministra, deputetë, kryekomisarë, prokurorë, gazetarë, psikologë etj., etj.. Në këtë reagim prej 42-fjalësh të prononcimit të tij nuk ekzistojnë fjalët 'dënim' apo 'ndëshkim' për kriminelin dhe aktin kriminal. Nuk merret në mbrojtje dhe nuk ekziston fjala 'mbrojtje' për viktimën, por sulm nga pozitat e një njeriu me standard më të ulët dhe shtazore, morale ndaj të gjithë atyre që dënuan, denoncan krimin e pushtetit ndaj një vajze të pambrojtur, viktime e epshëve shtazore të sadistit bir i pushtetit, Rexhep Rraja", shprehet z.Berisha.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

shpall ankandin, faza DYTE, për shitjen e pasurisë së palaujtshme me këto të dhëna: Trupat+ Ndërtëse me sip. totale prej 250 m2, nga ku truallt 250 m2, dhe ndërtesë 101 m2, nr. pasurisë 9/383, Vol. 16/ fq. 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. "Sheq i Madh" Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi. Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.640.000 (tre milion e gjatëdhjetë e dyzetë mijë) lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 25.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

shpall ankandin, faza e parë për shitjen e pasurisë së palaujtshme sipas Çertifikatës provizore për regjistrimin karabinë: Pasuri e palaujtshme, Apartament me sipërfaqe 70m², e regjistruar në regjistrin hipotekor me Nr.117, datë 28.04.2009, me Nr. Pasurie 62+1-1, në Zonën Kadastrale 3126, me Adresë: Shëngjin, Lezhë, regjistruar në emër të Shaban Elezi dhe Taze Smalaj, hipotekuar në favor të BKT BANK.

Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 2.400.000 (dy milion e katërtëdhjetë mijë) lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 16.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890/ 0693177499

SHOQËRIA PËRBARIMORË GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fishtë Dëshia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
Web: www.3h.al; Email: sh@3h.com; tel. 0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.25.09.2018 deri ne dt. 05.10.2018 per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M Cmimi fillestar eshte 1419 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyrën përbarimorë ne datën 05.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.

DIPLOMACIA TAKIMI

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së vlerëson kontributin e Shqipërisë për paqen, premtom mbështetje

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta i shprehur dhe nga afër sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres ambicien e Shqipërisë që të jetë anëtare e Këshillit të Sigurimit. Gjatë qëndrimit në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Presidenti i Republikës, Ilir Meta zhvilloi një takim të veçantë me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së. Presidenti Meta vlerësoi edhe njëherë lidhshimin e zotit Guterres në përpjekjet e tij për të reformuar Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe për të avancuar 'Agjendën 2030'. Presidenti Meta e siguroi sekretarin e përgjithshëm, Guterres se Shqipëria u mbet besnike parimeve themelore të Organizatës dhe mbështet diplomacinë parandaluese në dobi të paqes, sigurisë, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Presidenti Meta nënvizoi qëllimin kombëtar të Shqipërisë për tu anëtarësuar në BE dhe rëndësinë që i gjithë rajoni, në frymën e integritimit të tij evropian, të forcojë bashkëpunimin rajonal. 'Shqipëria, nënvizoi Presidenti Meta, po luan një rol të rëndësishëm konstruktiv në rajon dhe ambicia

Meta takon Guterres: Ambicia e Shqipërisë, të jetë anëtare e KS

"Gati edhe për anëtarësimin në BE"



Presidenti Ilir Meta dhe sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres

e saj për të qenë anëtare e Këshillit të Sigurimit për vitet 2022-2023 do të jetë vazhdimësi e kontributit të saj në interes të paqes e sigurisë rajonale e globale dhe një zë përfaqësues i rajonit tonë në këtë or-

ganizatë të rëndësishme", tha Meta. Edhe sekretari i përgjithshëm Guterres e vlerësoi rolin shumë të rëndësishëm të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe e siguroi Presidentin

Meta për mbështetjen e projekteve zhvillimore në Shqipëri dhe në rajon. Presidenti Ilir Meta gjatë qëndrimit në SHBA, në kuadër të Konferencës Ndërkombëtare të OKB-së zhvilloi një takim me drej-

TAKIMI
Presidenti Meta gjatë qëndrimit në SHBA, në kuadër të Konferencës Ndërkombëtare të OKB-së ka zhvilluar një takim me drejtuesit e organizatës "Vatra". Meta shkruan në "FB", se është takuar me drejtuesit e kësaj organizate dhe i ka falënderuar për mbështetjen e Shqipërisë dhe çështjeve shqiptare.

tuesit e organizatës "Vatra". Meta në një postim në "Facebook" shkruan se është takuar me drejtuesit e kësaj organizate dhe i ka falënderuar për mbështetjen e Shqipërisë dhe çështjeve sh-

qiptare. "Kënaqësi të takohesha dhe të bisedoja me drejtues, përfaqësues dhe kryetarë të disa degëve në SHBA të Organizatës Panshqiptare 'Vatra' dhe t'i falënderoja për mbështetjen e Shqipërisë dhe çështjeve shqiptare", shprehet z.Meta. Dy ditë më parë Presidenti Ilir Meta përshëndeti vëmendjen e BE-së drejtuar Ballkanit Perëndimor, teksa theksoi se Shqipëria është e vendosur të mos humbasë më kohë për perspektivën evropiane. "Presim një vendim pozitiv në të ardhmen për të hapur negociatat e pranimit me Bashkimin Evropian. Ne mbetemi të përkushtuar për të ecur përpara dhe pa vonesë me reformat e brendshme në fusha kyçe. Me proceset e vazhdueshme të paqes e të integritimit në Ballkan, besojmë se do arrijtë dypalëshe në gjirin e vendeve tona kontribuon drejtpërdrejt edhe për një paqe, siguri, qëndrueshmëri dhe zhvillim ekonomik më të madh", theksoi z.Meta. Në fjalën e tij në Asambelën e Përgjithshme të OKB-së, kreu i shtetit shprehu mbështetjen e Shqipërisë për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Meta nënvizoi se angazhimi i kombinuar i NATO-s dhe Bashkimit Evropian përbën garantuesin më të mirë për Ballkanin.

"Çamët ndihmuan nazistët, Shqipëria të pranojë faktin!"

Pavlopoulos: Nëse Shqipëria do mbështetje, të harrojë çështjen çame



ku Shqipëria synon të hyjë, është ngrehina që ukrijua për mos t'i jetuar kurrë më ato krime, ato mizori", theksoi presidenti grek. Pavlopoulos foli të shtunën në një veprimtari përkujtimore të zhvilluar në Paramithia, ku në 29 shtator 1943 u vranë 49 greke

"nga nazistët dhe bashkëpunorët e tyre shqiptarë çamë", sipas historiografisë greke. Pavlopoulos shtoi: "I themi krejt sinqerisht, nëse e do miqësinë tonë dhe fqinjësinë e mirë, mbështetjen tonë në rrugën e saj evropiane që është e domosdoshme, duhet që menjëherë të pranojë të vërtetën e padiskutueshme historike të së kaluarës kriminale naziste të çamëve dhe të mos e përmendë kurrë në marrëdhëniet ndërmjet nesh. Çdo herë që e përmend, është çështje nderi për ne. Le ta kuptojnë, nuk është hakmarrjeje. Është çështje drejtësie. Nuk kam ndërmend që të provokoj

përçarje, mirëpo është obligim i elementar që të rehabilitoj historinë, duke u thënë fqinjëve se çfarë është ajo që mund të na bëjë të ecim së bashku, por edhe çfarë është ajo që në mënyrë të panegociueshme do të kundërshtojmë, jo vetëm për Greqinë, por edhe për vetë familjen evropiane", tha presidenti grek. Pavlopoulos u shpreh se, "çamët nuk u larguan të përndjekur nga Thesprotia, siç pretendojnë, por që të mos gjykohehin si bashkëpunorët të nazizmit, sepse duhej të gjykohehin, pasi kryen krime kundër njerëzimit".

Senatori italian takon Veliajn: Pikë referimi për qeverisjen e mirë

Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj priti dje sena

torin italian, Luciano D'Alfonso. Veliaj dhe D'Alfonso folën për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve, nxitjen e investimeve italiane në Shqipëri dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira mes dy vendeve në fusha të ndryshme. Senatori italian vlerësoi ndryshimet që ka pësuar Tirana dhe theksoi se kryebashkiaku Veliaj përfaqëson një gjetim të mirë referimi jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar për qeverisjen e mirë. "Jam shumë i kënaqur që gjendem sërisht në qytetin e Tiranës, për t'u përshëndetur me kryebashkiakun e Tiranës, i cili për mua përfaqëson një pikë referimi jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar për qeverisjen e mirë", tha D'Alfonso. Ai vlerësoi përparimin që po bëjnë kryeqyteti shqiptar në përmirësimin e infrastrukturës dhe të cilësisë së jetës së qytetarëve. Kryebashkiaku Veliaj bëri një paraqitje të transformimit të Tiranës, duke u ndalur në mënyrë të veçantë te punët dhe zhvillimi që ka pësuar kryeqyteti shqiptar në vitet e fundit.



ERION VELIAJ

"Qeveritë ndërronjë, por njerëzit mbeten dhe raporti që kemi mes njerëzve është një raport i jashtëzakonshëm, ndaj mezi pres gjithashtu që investimet abruceze në Tiranë apo në Shqipëri, ato që janë biseduar edhe me kryeministrin, edhe me bashkinë të mund të ecin përpara", tha z.Veliaj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimore "Best 2010"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 19 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e l-rë, për shifren e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq 39, ZK.8350, sip. 103.90 m2 me çmim fillestar 81.600 lek/m2.

Apartamenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT 'ARË', VOLUMI 1, FAQJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPERFAQJE 4.453 m2, NË ADRESËN: XHAFTOZAJ, DURRËS, NË PRONËSI TË Z. NEXHMI VORA,

ÇMIMI 17.812.000 LEKË.
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.10.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866

Njoftim për shitje me ankand te dyte

Sh. "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e dorëzuar në K.S të ndodhur në Panshoro Mallakastor. Pasuria që shitet në ankand përshëtet nga: Pasuria "Ara" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869 Mallakastor, me çmim 840.000 lekë. Pasuria "Ara" me nr. 206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869 Mallakastor, me çmim 56.000 lekë. Pasuria "me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 dhe ndodhet në Mallakastor me çmim në masën 230-485 lekë.
Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet dt 18.10.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishat" Kulla 1, Kati 2, zyra 5. Kont tel: 672082543, e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

Gjykata lë në burg 21-vjeçarin. Prokuroria: Rrezikon burgim të përjetshëm

Masakroi gjyshen me 20 goditje thike në trup e në kokë, Redmond Gruda: Jam penduar

I riu, i dënuar edhe dy herë të tjera për plagosje, të parën e kreu kur ishte vetëm 11 vjeç

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Gjykata e Shkallës së Parë të Durrësit dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 21-vjeçarit Redmond Gruda, i cili mesditën e së enjtes masakroi me 20 goditje thike gjyshen 81-vjeçare, Floresha Shkurti. Rreth orës 10:30, i riu i veshur me atlete dhe me duar të lidhura pas shpine, doli para trupit gjykues që kryesohej nga gjyqtarja Aida Kaja. Gjatë seancës gjyqësore, autori i krimit që tronditi banorët e qytetit të Durrësit është treguar krejt i ftohtë, ndërsa asnjë nga familjarët e tij nuk ishin të pranishëm. Ngjarja e rëndë për të cilën akuzohet Gruda ndodhi në katin e tretë të një pallati në lagjen nr.16 të këtij qyteti, ndërsa ende nuk janë zbardhur motivet. Gjatë fjalës së tij, 21-vjeçari ka pranuar autorësinë. "Po, unë e vrava gjyshen dhe jam penduar për krimin që ka bërë", ka thënë i pandehuri. I pyetur përse e masakroi të moshuarën, Redmond Gruda ka heshtur dhe nuk ka kthyer përgjigje. Ndërsa ka pohuar se ka qenë duke vuajtur dënimin për një plagosje (ishte me masë sigurie "Detyrim paraqitjeje". Ndërkaq, prokurori i çështjes, Pali Decolli u kërkoi togave të zeza të Durrësit lënien në burg të autorit të ngjarjes së ndodhur pak ditë më parë, duke argumentuar se Redmond Gruda është person me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Mësohet se 21-vjeçari është proceduar dhe dënuar edhe dy herë të tjera për plagosje, dhe se plagosjen e parë e ka kryer kur ishte vetëm 11 vjeç. Gjithashtu, përfaqësuesi i organit të akuzës u shpreh gjatë seancës se ekziston dyshimi për vrasje në kushte të marrëdhënieve familjare dhe për këtë, autor i dyshuar është Redmond Gruda. "Kemi të bëjmë me një veprë që dënohet me burg të përjetshëm. Autori ka rrezikshmëri. Kërkoj vlerësim të ligjshëm të arrestit me burg", u shpreh prokurori Decolli. Sipas burimeve zyrtare nga policia dhe prokuroria e qytetit bregdetar, bënë me dije se 81-vjeçarja u gjet e pajetë në dhomën e gjumit, ndërsa kishte plage në kokë, qafë, krahë dhe duar, të shkaktuara me mjet prerës. Ndërsa në tualet u gjeten rrobat, një çantë, si dhe një thikë e këputur. Në fund të seancës, trupi gjykues vendosi lënien në qeli të Redmond Grudës.



Viktima Floresha Shkurti



21-vjeçari Redmond Gruda, dje në gjykatë

PROKURORI

Përfaqësuesi i akuzës, Pali Decolli, u kërkoi togave të zeza të Durrësit lënien në burg të autorit të ngjarjes së ndodhur pak ditë më parë, duke argumentuar se Redmond Gruda është person me rrezikshmëri të lartë shoqërore. "Kemi të bëjmë me një veprë që dënohet me burg përjetë. Autori ka rrezikshmëri. Kërkoj vlerësim të ligjshëm të arrestit me burg", u shpreh prokurori Decolli.

VIKTIMA

Sipas burimeve zyrtare nga policia dhe prokuroria e qytetit bregdetar, bënë me dije se 81-vjeçarja u gjet e pajetë në dhomën e gjumit, ndërsa kishte plage në kokë, qafë, krahë dhe duar, të shkaktuara me mjet prerës. Ndërsa në tualet u gjeten rrobat, një çantë, si dhe një thikë e këputur. Në fund të seancës, trupi gjykues vendosi lënien në qeli të Redmond Grudës.



Zjarri në Fushë-Arrëz, bashkia: Flakët rrezikojnë banesat

PUKË - Situata e zjarreve në Fushë-Arrëz po del jashtë kontrollit. Përfaqësues të bashkisë kanë bërë apel për ndërhyrje nga ajri, pasi flakët po u afrohen shtëpive të banimit. Ndue Doda, nënkryetari i bashkisë ka kërkuar dje të ndërhyhet sa më parë me mjete ajrore, sepse terreni i vështirë dhe era po ndihmon në flakët të shpërhapen me shpejtësi drejt banesave të banorëve. Mësohet se zjarri ka përfshirë sipërfaqe me pyje në zonën e Lumbardhit, ndërsa ndërhyrja e mjeteve zjarrfikëse është e pamundur për shkak të terrenit malor. "Situatë alarmante, zjarri përfshiu pyjet. Zjarrfikëset e kanë të pamundur të vënë zjarrin nën kontroll. Kërkojmë ndërhyrje nga ajri. Zjarret po u afrohen edhe banesave të banorëve", tha nënkryetari i bashkisë, Ndue Doda. Mësohet se për shuarjen e flakëve të zjarrit në Fushë-Arrëz është përfshirë në operacion helikopteri "Cougar" i Forcave të Armatosura. Përveç helikopterit, në operacion në Fushë-Arrëz prej orësh janë angazhuar edhe dhjetëra efektivat të repartit ushtarak të Vaut të Dejës.

Fqinjët e viktimës: Jemi të shokuar nga ngjarja, kjo është dita e qametit



Fqinja e familjes Shkurti, duke folur për "GSH"

iu nda as në fund të jetës", thanë fqinjët e viktimës. "E mirë ishte e shkreta me të gjithë. Ishte grua e qetë. Nuk kemi dëgjuar për ndonjë sherr. Pasi morëm vesh lajmin, jemi habitur. Ndihe mi të frikësuar nga

kjo që po ndodh në familjet shqiptare. Të ngrejë dorë dhe të vrasë nipi gjyshen që e ka rritur, ush-ur dhe i ka dhënë dashuri gjatë gjithë jetës është e tmerrshme", pohoi një fqinje tjetër e 81-vjeçares Floresha Shkurti. Ndërsa, një tjetër fqinje e viktimës tha: "Jemi tronditur nga ajo që ndodhi. Të vrasë nipi gjyshen që e ka rritur mes vuajtjesh të mëdha është e tmerrshme. Ka ardhur dita e qametit. Ky është qameti i madh".

shtoheshin. Sot (dje) debatova shumë me gjyshen dhe në gjaknxehtësi e sipër e godita me majën e thikës në kokë", ka thënë 21-vjeçari, Redmond Gruda, i cili akuzohet për vrasje me dashje. Mësohet se viktima jetonte me nusen e djalit dhe nipin e saj, pasi djali i saj kishte ndërruar jetë disa vite më parë nga një sëmundje e rëndë. Burime nga grupi hetimor pohuan se i riu ka tentuar të fshehtë provat e krimit dhe se ishte ekspertiza që saktësoi se 81-vjeçarja Floresha Shkurti ishte vrarë me thikë pas koke dhe nuk kishte pësuar vdekje aksidentale, siç u dyshua fillimisht.

Tentuan të trafikonin kanabis sativa në Mal të Zi, prangosën në Muriqan dy të rinj



SHKODËR - Dy të rinj janë arrestuar paraditen e djeshme në Pikën e Kalimit Kufitar të Muriqanit, pasi tentuan të kalojnë drejt Malit të Zi me 8 kg kanabis të fshehur poshtë sediljeve të makinës. Por tentativa e dy shtetasve, Vullnet Kolaveri, 23 vjeç, nga Sukthi dhe Denis Dedaj, 28 vjeç, nga Shijaku ka dalë huq, pasi janë zbuluar nga policia, duke përfunduar në pranga. Gjatë

kontrollit të ushtruar në vijën e dytë, në mjetin tip "Mercedes-Benz", me të cilin udhëtonin dy të rinjtë është gjetur e fshehur sasia e drogës. Materialet në ngarkim të tyre iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve e kryer në bashkëpunim", "Prodhim e shitje të narkotikeve" e "Kultivimi i bimëve narkotike".

TIRANË - Policia shqiptare në bashkëpunim me SHÇBA-në, Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe partnerëve amerikanë kanë finalizuar një megaoperacion, i cili nisi që në mars të këtij viti. Bëhet fjalë për operacionin e koduar "One If By Land", që u zhvillua në kuadër të goditjes së kontrabandimit të personave me qëllim emigrimin drejt SHBA-ve, Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në një konferencë të mbajtur ditën e djeshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale Eduart Merxaj bëri me dije se nga veprimet hetimore të kryera rezultuan se 7 grupe të strukturuar kriminale, të cilat opero-

Megaoperacioni "One If By Land", 2 policë në pranga

"25 mijë dollarë për në SHBA dhe 7 mijë paund për në Britani", policia: 300 persona të kontrabanduar

ITINERARET

Pjesëtarët e këtyre grupeve kriminale përdorin itineraret: Shqipëri-Itali-Mbretëri e Bashkuar, Shqipëri-Francë-Mbretëri e Bashkuar, Shqipëri-Bullgari-Belgjikë-Republika Domenikane-SHBA/Kanada si dhe Shqipëri-Spanjë-Amerika Latine-SHBA/Kanada.

nin në Shqipëri, Bullgari, Spanjë, Francë, Republikën Domenikane, Itali, Mbretëri e Bashkuar, SHBA, Kanada, kanë mundësuar kontrabandimin e mbi 300 personave (shtetas shqiptarë) në drejtim të vendeve si

veprimeve aktive ndihmonin shtetasit shqiptarë të interesuar për të emigruar në mënyrë të paligjshme drejt vendeve të mësipërme, duke falsifikuar dokumente udhëtimi dhe identiteti të vendeve të BE-së", tha Merxaj. I gjithë hetimi është zhvilluar me metoda speciale nga Policia e Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ka zgjatur disa muaj. Në datën 17 mars 2018 u finalizua me sukses pjesa kryesore e këtij operacioni ku u arres-



tuan 39 persona. Ndërkohë, hetimi intensiv ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Falë bashkëpunimit midis SHÇBA, oficerët të Departamentit të Policisë Kriminale dhe të Institutit të Policisë Shkencore është bërë e

mundur që të identifikohen dhe më pas të arrestohen në datën 28 shtator 2018 si bashkëpunëtorë në këtë grup të strukturuar kriminal 2 punonjës policie me detyrë kontrollor (roje kufitare në PKK Rinas si dhe një agjent i kompanisë ICTS në aeroportin të Gjakatës së Krimeve të Rënda, punonjësit e policisë: Almir Doda, Lindur në Mirditë dhe banues në Tiranë, për veprat penale të "Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve" kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe Edmond Llaçini, për kryerjen e veprave penale të "Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve" kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal.

Gjyqi te Krimet e Rënda, 37-vjeçari akuzohet për "Kanosje për dhënie pasurie"

Gjobë 90 mijë euro biznesmenit, lihet në burg vrasësi i Miri të Xhikes

Lavdërim Tufa u arrestua pas denoncimit të administratorit të një firme

TIRANË
Gjykata e Krimeve të Rënda ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për Lavdërim Tufën, ish-i dënuar për vrasjen e Fatmir Ramës, i njohur si Miri i Xhikes. Pasi rifitoi lirinë e parakohshme, rreth 3 vite më parë, Tufa u rikthye prapë në qeli, pasi kësaj here dyshohet për gjobëvënie. Arrestimi i tij u bë nga Policia e Tiranës katër ditë më parë, pasi është denoncuar nga një biznesmen, të cilin e kërcënonte për t'i dhënë 90 mijë euro. Një pjesë e këtyre parave, sipas burimeve nga Policia, ishin për llogari të një shtetasi italian, i cili pretendonte se i detyrohej biznesmeni i dëmtuar. Ndërsa pjesa tjetër, një shumë e konsiderueshme, ishte "hak pune" për Lavdërim Tufën, si person i "pajtuar" nga italian me iniciale P.E., 50 vjeç, për të marrë paratë. Shtetasi i huaj është shpallur në kërkim bashkë me një 49-vjeçar me inicialet A.G. nga Durrësi, të dyshuar për bashkëpunim në këtë ngjarje. Ndërsa një tjetër, shtetasi me iniciale F.Sh., 37 vjeç, është proceduar në gjendje të lirë, pasi sipas policisë ka qenë në dijeni të ngjarjes, por nuk e ka kallëzuar. Hetimet nisën nga oficerët e Krimeve të Rënda të Policisë së Tiranës, pas kallëzimit të biznesmenit dhe përgjatë disa ditëve Lavdërim Tufa u mbajt nën vëzhgim derisa u siguruan provat e nevojshme për veprën penale "shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie". Në secënën e djeshme, Gjykata e Krimeve të Rënda e la në qeli Lavdërim Tufën, mbi të cilin rëndon akuzat "Kanosje për dhënie pasurie".

ARRESTIMI
Më 27 gusht, policia Tiranës bëri me dije se është arrestuar shtetasi Lavdërim Tufa, 37 vjeç, pasi dyshohet se ka shtrënguar me anë të kanosjes një shtetas për



37-vjeçari i arrestuar, Lavdërim Tufa

dhënie pasurie. Blutë pohan se Tufa, i dënuar më parë për vrasje, i ka kërkuar shumën prej 90 mijë eurosh duke e kanosur, administratorin e një firme private, me pretendimin se ky i fundit kishte detyrim ndaj shtetasit italian P.E., 50 vjeç. Policia tha se gjithashtu

u procedua në gjendje të lirë për "Moskallëzim Krimi" shtetasi F.Sh., 37 vjeç, banues në Tiranë, i cili ka pasur dijeni për rastin dhe nuk ka kallëzuar pranë shërbimeve të policisë. Në lidhje me rastin u shpallën në kërkim edhe 2 shtetas të tjerë dhe po punohet

për kapjen e tyre, P.E., 50 vjeç, banues në Itali dhe A.G., 49 vjeç, banues në Durrës. Sipas burimeve të mësipërme, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit Lavdërim Tufa u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një antiplumb. Ndërsa, në

KUSH ËSHTË LAVDËRIM TUF

37-vjeçari Lavdërim Tufa, i cili u vu në ranga pak ditë më parë me akuzën e kërcënimit të një biznesmeni në Tiranë për llogari të një italianit është një emër i njohur për drejtësinë shqiptare. Ai u dënua me 20 vite burg për vrasjen e biznesmenit Fatmir Rama (i njohur si Miri i Xhikes) në Tiranë, por u lirua pas 11 vitesh. Ngjarja, për të cilën ai u dënua ndodhi mbremjen e 29 marsit të 2003-it.

ngarkim të 4 personave të përfshirë në këtë ngjarje janë referuar materialet në Prokurorinë e Tiranës për veprat penale, "Shtrëngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie", "Moskallëzim krimi" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës".



Sulmoi me gurë makinën e Ilir Beqas, arrestohet 28-vjeçari

TIRANË - Policia e Tiranës ka vënë në pranga një 28-vjeçar, i cili dy ditë më parë sulmoi me gurë makinën e ish-ministrit të Shëndetësisë, Ilir Beqja. Bëhet fjalë për të riun Edison Osmenllari, banues në kryeqytet që u kap në kushtet e flagrancës. Sipas policisë, Edison Osmenllari dyshohet se në gjendje depressive, në bulevardin "Bajram Curri" ka thyer me sende të forta xhamat e mjetit tip "Tuar-eg" në pronësi të Beqajt, si dhe xhamat e një makinë me targa diplomatike. Gjithashtu 28-vjeçari ka kundërshtuar edhe punonjësit e policisë në momentin e shoqërimit. Aktualisht i riu ndodhet në Spitalin Nr5 për mjekim dhe mbahet nën mbikëqyrje nga shërbimet e policisë. Ndërsa materialet në ngarkim të tij u referuan prokurorisë për veprat penale "Shtkatërrim prone" dhe "Kundërshtim i punonjësit të rendit publik".



U kapën me 8 milionë paund kokainë në makinë, 2 shqiptarët presin dënimin

ANGLI - Dy shqiptarë në Britaninë e Madhe janë shpallur fajtorë, pasi akuzohen për trafik droge. Haxhi Shehu, 34 vjeç dhe Fitim Prenci, 39 vjeç me banim në "Newlands Street", akuzohen për posedim të 81 kg kokainë. Ata u ndaluan disa muaj më parë, pasi gjatë kon-

trollit në makinë u gjetën 79 kg kokainë të vendosura në 4 cantat të mëdha në bagazhin e makinës. Një tjetër cantë me drogë dhe një sasi e madhe parash kesh u gjetën gjatë kontrollit të banesës. "Met.co.uk" shkruan se droga nëse do të hidhej në treg do të sillte një përfitim prej 8

milionë paund. "Ishte një operacion i shpejtë falë të cilit policia arriti të heqë nga tregu një sasi të madhe kokainë", u shpreh Liam Hurley, një dedektiv policie. Gjykata e Londrës vendosi që dënimi për Haxhi Shehun dhe Fitim Prencin të jepet në një datë tjetër.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status (e.g., DOSJE PA VENDIM). Includes entries like LYMAN TAJFI, KADRI HOXHA, RAMAZAN HOXHA, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like XHELAJ ALI KASHARI, RIFAT TARTARI, MUSTAFA KACUJI, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like KURT ARUÇI, XENOFON SHETI, SAMI PASHALLIU, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like RAMAZAN BALI, IBRAHIM MUÇA, BALAJE DYRMESE, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like ABDURRAMAN PIZA, SPIRO METANI, SHAQIR IRMO, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like XHEMAL ALI MENIKLI, MUSTAFI A. MENIKLI, HAMIT MEMOLLA, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like ADEM RROGSHI, FERHAT NAZE TRUALLI, ALI RAMADHI, etc.

Table with 5 columns: Name, Address, Area (M2), Price (M2), and Status. Includes entries like GJIVE HASA, SOLOD KALAJA, ABDULLA HANMISA, etc.

(vijon nesër)

IN MEMORIAM

GILMAN BAKALLI

Për dashnorët dhe dhunuesit e fjalës së lirë

Fatmira Nikolli

Teatri i politikës shqiptare është mbushur me dashnorë mediash, me dashnorë të fjalës së lirë, me flirtues, me tundues e përdhunues të fjalës së lirë, të cilët fjalën e lirë e konsiderojnë si e drejta për të shpërndarë në hapësirë budallallëqe dhe ligësi. Pa u ndëshkuar, sigurisht! Skena e këtij teatri pret prej kohësh të dashuruarit e fjalës së lirë. Të dashuruarit me fjalën e lirë! Ato që, fjalën e lirë e ndjekin nga pas, pa mundur ta kapin asnjëherë e që bash për këtë arsye s'preshtin së ndjekuri". Me frazat që la të shkruara, me mendimet për të cilat pati afër shumë miq, me këshillat për të cilat u çmuua, me gjykimet për të cilat s'qe e lehtë ta bindje se e zeza është e bardhë, Gilman Bakalli kujtohet në këtë përvjetor të ikjes prej të gjallëve, krejt i ri, shumë herët dhe aq papritur.

Botimet "Pegi", së bashku me familjen kanë mbledhur në një botim të vetëm gjithë publicistikën e tij. Në këtë përmbledhje janë "fotografuar" momente të ndryshme të politikës, etikës, moralit, fesë, mediave etj. të shoqërisë shqiptare gjatë këtij "tranzicioni të përthshëm". Në trajtimin e çështjeve, autori ka zgjedhur si model të tijin të preferuar mendimin kritik. Me anë të mendimit kritik, autori analizon dhe vlerëson informacionet, duke na dhënë një mënyrë për të mësuar zgjidhjen e problemeve të jetës.

Ai mendonte se qeveritë e shteteve të varfra e duan identitetin për ta mbajtur popullsinë të nënshtruar edhe pa ia siguruar mirëqenien e premtuar, ashtu si edhe qeveritë e shteteve të pasura e duan identitetin sidomos kur bëhet fjalë për ruajtjen e kufijve. Shkurt - thoshte ai - identiteti është gjithmonë në modë dhe sa më faktiv të jetë, aq më shumë adhurohet ai. Për gjithë çfarë thoshte e gjithë çfarë shkruante, dallonte prej shumë shkruesish, sepse publicistika e tij ishte analizë në ndërtim. Palë përvojës së tij si pedagog, i specializuar në shkencat e komunikimit, nëpërmjet mendimit kritik ai bazohet në përpjekjen për të marrë vendime të paanshme, ku vlerat themelore janë: qartësia, rregullia, saktësia dhe provat. Duke u bazuar në rezultatet e fundit të psikologjisë konjitive edhe Bakalli, si

shumë edukatorë modernë, mendon se është më e dobishme (sidomos për studentët), të praktikojmë një mënyrë të menduarit kritike sesa të mësojmë përmendësh një sasi të madhe informacionesh.

"Kemi parë gjithfarë mutacionesh të konceptit mbi guximin, por atë lloj guximi që lipset për një vend demokratik, atë për të cilin ia vlen të flitet përnjëmend, atë që e shtyn përpara një shoqëri njerëzore, nuk e kemi parë. E kam fjalën për guximin qytetar. (...) Në një shoqëri të përparuar njerëzore, ka vetëm një lloj guximi, ai që quhet guxim qytetar", shënon të Bakalli.

Ai e shihnte mendimin kritik si aftësi konjitive: të proceseve të njohjes së kuptuar funksionalisht, pra për t'i përdorur këto aftësi si një udhërrëfyes për sjelljen tonë. Prandaj mendimi kritik nuk përfshin vetëm marrjen dhe memorizimin e informacioneve e nuk përfundon në zotërimin e një ose disa aftësive që do të përdoren vetëm një herë, por përkon me përdorimin e këtyre aftësive që do të zbatohen në vazhdimësi. Për të arritur një mendim kritik, autori nuk ndjek një radhë hapash të detyrueshëm: ai paraqet opinionet e ndryshme mbi çështjen që është duke shqyrtuar, duke e analizuar atë në çdo aspekt. Duke shqyrtuar argumentet që përdoren për të mbështetur çështjen, ai e nënndon çdo argument në përbërësit e tij themelore, pra në propozime të thjeshta dhe vlerëson pasojat e çdo propozimi. Gjatë leximit shohim se si autori mundohet të zvogëlojë paragjykimet në mënyra të ndryshme, ai shpesh shtron



Gilman Bakalli

"Mendimi kritik i një qytetari", botohet publicistika e Bakallit

pyetje të cilat fillojnë me përmirimin pyetës "çfarë" si: "Çfarë do të thotë kjo?" në vend që të mbetet i gozhdur në pyetjen "Si është e mundur që kjo gjë është në kundërshtim me atë që kam besuar gjithmonë?". Paragjykimet, stereotipat dhe iluzionet konjitive vazhdojnë të veprojnë në mendjen njerëzore me prepotencë e futen deri në shpirt, por një mendimtar kritik duhet të jetë në gjendje të dallojë situatat në të cilat është me vend t'i frenojë. Leximi dhe studimi i përmbledhjes së publicistikës së prof. Bakallit është sigurisht një usht-

rim i vlefshëm për të zhvilluar mendimin kritik.

"Nuk dimë të diskutojmë pra, sepse thelbi ynë dhe i




politikës sonë nuk është logosi, por patosi. Prandaj kemi pasur dhe kemi me bollëk poetë, por pak filozofë. Jemi gjenialë në patetizëm, por të vobektë në arsyetim. Nuk dimë të diskutojmë sepse, në thelb, nuk e pranojmë pyetjen. Nuk pyesim! Duam të shkojmë në Evropë, por jemi të vetmit evropianë, të cilët vendosmërinë e tyre për diçka e shprehin duke thënë 'nuk pyes unë!'. Mirëpo kush nuk pyet, nuk pranon dialektikën dhe pa dialektikë nuk ka as debat e as konflikt", - shkruante Bakalli.

BIO

Gilman Bakalli (Shkodër,

1967 - Tiranë, 2016), opinionist, përkthyes dhe eseist, Prof. Asoc. Dr. në Shkencat Filologjike, është diplomuar në Universitetin Karl-Franzens, Graz (Austri). Ka punuar si lektor në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike, në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Edukimit në UET (Universiteti Europian i Tiranës). Ka dhënë mësim për më shumë se 8 vjet në UET dhe është specializuar në fushën e teorisë të letërsisë, përkthimit, komunikimit ndërkulturor dhe teorisë të komunikimit. Ka përkthyer nga gjermanishtja: "Hyrye në teorinë e letërsisë", T. Eagleton (Camaj-Pipa, Shkodër, 2005), "Ftesë për të filozofuar", J. M. Bocheński (Shkodra University Press "A" "E" Prishtina University Press, 2000), "E gjithë jeta është zgjidhje problemesh", Karl R. Popper (Camaj-Pipa, Shkodër, 2002). Ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë në mandatin 4-vjeçar 2005 - 2009. Në vitin 2016, u emërua administrator i një kompanie në Tiranë. "Alfabeti i tranzicionit" ka qenë libri i parë që u publikua nën përkujdesjen e UET-it, të cilin autori arriti ta përfundonte pak kohë përpara ndërprerjes së punës në mënyrë të papritur. "Mendimi kritik i një qytetari" është një përmbledhje me publicistikën e zgjedhur të autorit, që botohet nga "Botime Pegi" me rastin e dyvjetorit të ndarjes së autorit nga jeta.



Një lajm të mirë që ka lidhje me zhvillimet dhe vëmendjen e shtuar që qarqet universitare evropiane i kushtojnë gjithmonë e më shumë letërsisë shqipe dhe specifikisht këtë herë dy përfaqësuesve të saj, shkrimtarë shqiptaro-zviceranë Besa Myftiu dhe shkrimtarit shqiptar, Ylljet Aliçka. Ata do të jenë pjesë e dy takimeve letrare, që Biblioteka Universitare e Gjuhëve dhe Civilizimeve "Boulaç", në Paris do të or-

ganizojë këtë fillim-tetori, dedikuar posaçërisht letërsisë shqipe. Kjo gjë, natyrisht na bën të ndihemi krenarë dhe të jemi koherentë me ju për ngjarje të rëndësishme letrare që ndodhin jashtë kufijve të Shqipërisë. Takimi i parë do të organizohet më 6 tetor 2018, me temë qendrore "Letërsia shqipe nga një gjuhë në tjetër" dhe gjatë tij do të trajtohen çështje të tilla, si:

Cila është natyra e shkëmbimeve mes autorit dhe përkthyesit? Cilat janë vështirësitë dhe pengesat e përhapjes dhe eksportimit të letërsisë jashtë kufijve të Shqipërisë?

Takimi i dytë do të organizohet më 9 tetor 2018, me temë "Brenda dhe jashtë" dhe gjatë tij do të trajtohen çështje si: "Shkrimtarë nga Shqipëria dhe diaspora", "Hijet e komunizmit në letërsi-


PARIS, LETËRSIA SHQIPE NË BIBLIOTEKËN UNIVERSITARE



E DIEL

30 Shtator

2018



Studenti i Keimbrixhit, kushti i Enverit dhe Rose Wilder Lane

Rexh Meta (1906-1985), nga një banor i jeti mores së Shkodrës, bëhet shqiptari i parë që diplomohet me medalje të artë në Universitetin e Kembrixhit. Kjo falë fatit, aftësive të tij dhe shoqërimit që ai i bën gazetares amerikane më të paguar në botë, gjatë periudhës së pas-Luftës së Parë Botërore, Rose Wilder Lane. Rexh Meta dënohet me vdekje nga Enver Hoxha. Por, gazetarja, shkrimtarja dhe antropologja Rose Wilder Lane, sapo e mëson këtë fakt, ndërhyr gjer te Presidenti i SHBA për t'ia shpëtuar jetën atij. Enver Hoxha pranon t'ia falë jetën Metës, por me kusht që Rose Wilder Lane, që kishte një prestigj dhe influencë të jashtëzakonshme në mbarë botën, të mos fliste kundër regjimit komunist në Shqipëri. Lane e pranon kushtin e, për rrjedhojë, Rexh Metës i falet jeta. Por ai mbahet në burg për shumë vite, e më pas në internim, derisa vdes diku në afërsi të Tiranës, në të njëjtin vit që vdes dhe Enver Hoxha.



Shqipërimi i plotë i veprave homerike "Ilia da" dhe "Odisea me sfondin e tyre enciklopedik prej Dr. Ilia Vasil Ballaurit, përbën një ngjarje të rëndësishme për letërsinë, artin, kulturën dhe shkencat shqiptare. Kësaj arritjeje cilësore në të ardhmen do t'i kushtohen studime të shumanshme prej specialistëve të fushave të ndryshme, por unë do të sjell disa vlerësime për të pa pretendim shterues.

...Ilia V. Ballauri, Doktor i Shkencave Gjenetike dhe pedagog, sot 68 vjeç u lind në qytetin e Korçës në gjirin e një familjeje të pasur e të kulturuar me origjinë nga qyteti elitari i Voskopojës. Ai ka kohë që ka rënë në sy si intelektual i përkushtuar jo vetëm në profilin e tij, por edhe pas letrave, sidomos përkthimeve e përshtatjeve në gjuhën shqipe të shumë kryeveprave të letërsisë eu-

Shqipërimi i kryeveprave homerike në ditët tona

ropiane. Ai ka rreth njëzet e tetë vjet që jeton në Greqi dhe udhëton shpesh në Shqipëri, Gjermani dhe Austri ku ka fëmijët dhe të afërmit e vet. Eshhtë njohës i thellë i një sërë gjuhësh të huaja si greqishtja, anglishtja, frëngjishtja, italisht-

tja (me diplomë), është studiues i pasionuar i greqishtes së vjetër, latinishtes dhe sanskritishtes (për këtë të fundit ka pasuruar bibliotekën e vet, me një sërë botimesh të porositura në Neë Delhi). Ka studiuar për shumë vite

rusishten prej nga edhe ka përkthyer disa vepra. Po ashtu ai ka përkthyer sipas rastit prej gjermanishtes, spanjishtes, portugalishtes dhe rumanishtes.

Krahas punës për të sjellë në shqip letrare vepra të letërsisë mod-

erne europiane, ai shquhet edhe si njohës i thellë i botës së lashtë greke, veçanërisht i Homerit, Safos, Anakreontit (të cilët i ka shqipëruar të plotë), Platonit, Aristotelit, Hipokratit, Eskilit, Euripidit, Sofokliut, njohës i miteve, i historisë, geografisë dhe sidomos i shkencave të Greqisë së lashtë, për të cilat ka botuar disa libra, etj. Me punën e tij të këtyre 30 vjetëve të fundit, Ilia Ballauri është shqipëruesi më voluminoz i trashëgimisë së letërsisë e kulturës së Greqisë së lashtë. Veprat e sjella prej tij në shqip prej kësaj bote antike arrijnë në mijëra faqe.

→Vijon në faqen 16

A

ARGUMENT

Historia e Rexh Metës (1906-1985), nga një banor i jetimores së Shkodrës, bëhet shqiptari i parë që diplomohet me medalje të artë në Universitetin e Kembrixhit. Kjo falë fatit, aftësive të tij dhe shoqërimit që ai i bën gazetares amerikane më të paguar në botë, gjatë periudhës së pas-Luftës së Parë Botërore, Rose Wilder Lane. Rexh Meta dënohet me vdekje nga Enver Hoxha.

Rexh Meta dhe kushti që i vuri Enver Hoxha Rose Wilder Lane

Nga Ndrek Gjini

Rexh Meta (1906-1985), nga një banor i jetimores së Shkodrës, bëhet shqiptari i parë që diplomohet me medalje të artë në Universitetin e Kembrixhit. Kjo falë fatit, aftësive të tij dhe shoqërimit që ai i bën gazetares amerikane më të paguar në botë, gjatë periudhës së pas-Luftës së Parë Botërore, Rose Wilder Lane. Rexh Meta dënohet me vdekje nga Enver Hoxha. Por, gazetarja, shkrimtarja dhe antropologja Rose Wilder Lane, sapo e mëson këtë fakt, ndërhyr gjer te Presidenti i SHBA për t'ia shpëtuar jetën atij. Enver Hoxha pranon t'ia falë jetën Metës, por me kusht që Rose Wilder Lane, që kishte një prestigj dhe influencë të jashtëzakonshme në mbarë botën, të mos fliste kundër regjimit komunist në Shqipëri. Lane e pranon kushtin e, për rrjedhojë, Rexh Metës i falet jeta. Por ai mbahet në burg për shumë vite, e më pas në internim, derisa vdes diku në afërsi të Tiranës, në të njëjtin vit që vdes dhe Enver Hoxha.

PO KUSH ISHTE REXH META?

Babai i Rexhës, Metë Fazlia, bashkë me disa familjarë të tjerë, në vitin 1913 largohet nga Vuthajt për të shpëtuar familjen nga gjenocidi që u bëhej shqiptarëve në krahinën e Plavës dhe Gucisë nga forcat malazeze. Pasi shkojnë për disa vite në Kosovë, në vitin 1919, Metë Fazlia me djalin, Rexhën dhe dy vajzat, Gjyken dhe Zojën, kthehen dhe jetojnë në Shkodër. Aty, Metë Fazlia dhe gruaja e tij vdesin, kështu që Rexha dhe dy motrat e tij strehohen në jetimoren e Shkodrës, që varej nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Rexha aty nis shkollimin dhe mëson në mënyrë të shkëlqyer gjuhën angleze. Që 12 vjeç fillon të shoqërojë ekspeditat anglo-amerikane në Veri të Shqipërisë si përkthyes. Por, ekspedita që i ndryshoi jetën këtij djaloshi, ishte ajo që udhëhoq nga Rose Wilder Lane. Ajo u kujdes për të (disa burime thonë se ajo e birësoi Rexhën) dhe i siguroi bursën për në shkollën teknike "Harry Fultz" në Tiranë. Lane e dërgoi Rexhë Metën më pas në Universitetin e Kembrixhit në Angli, në Fakultetin e Financave, të cilin Rexh Meta e kreu me sukses duke mbrojtur në vitin 1937 edhe temën e doktoraturës në lëmin e ekonomisë financiare. Në Librin e Artë të Universitetit të Kembrixhit gjendet edhe emri i shqiptarit Rexhë Meta.

Më 1938-n ai kthehet në Shqipëri dhe filon punën si drejtor i Drejtorisë së Financave të Shqipërisë. Dy vjet me pas internohet në Itali, ku qëndron deri më 1943-shin. Në verën e vitit 1943 kthehet në Shqipëri dhe në shtator të po këtij viti ai merr pjesë në mbledhjen themeluese të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, si një nga 45 përfaqësuesit e kësaj lidhjeje, përkrah figurave të tilla si Ismet Boletini, Xhafer Deva, Shaban Poluzha, Rexhep Mitrovica, Marie Kraja e shumë patriotë të tjerë.

Menjëherë pas Luftës, Rexh Meta arrestohet nga pushteti komunist në Shqipëri

Rexhë Meta

Që 12 vjeç fillon të shoqërojë ekspeditat anglo-amerikane në Veri të Shqipërisë si përkthyes.

Por, ekspedita që i ndryshoi jetën këtij djaloshi ishte ajo që udhëhoq nga Rose Wilder Lane. Ajo u kujdes për të (disa burime thonë se ajo e birësoi Rexhën) dhe i siguroi bursën për në shkollën teknike "Harry Fultz" në Tiranë. Lane e dërgoi Rexhë Metën më pas në Universitetin e Kembrixhit në Angli, në Fakultetin e Financave, të cilin Rexh Meta e kreu me sukses duke mbrojtur në vitin 1937 edhe temën e doktoraturës në lëmin e ekonomisë financiare.



Rose Wilder Lane

dhe dënohet me vdekje. Rose Wilder Lane e mëson këtë lajm dhe ndërhyr deri te Presidenti i SHBA që atij t'ia falet jeta. Enver Hoxha vë kushte. Lane, për hir të jetës së Rexh Metës, e pranon kushtin dhe dënimi i tij shndërrohet me 27 vjet burg. Ai e kreu dënimin në qelitë e Burgut të Burrelit. Familja e Rexhës, gruaja Pertefi, djali Fitimi dhe vajza Bora, përjetuan vuajtje, persekutim dhe mjerim ekstrem.

Rexh Meta vdiq afër Tiranës në vitin 1985 (vit në të cilin vdiq dhe Enver Hoxha). Trupi i tij u varros në Shkodër.

NJË SHTATORE PËR REXHËN DHE ROSE WILDER LANE

Nuk e di nëse dikush është kujtuar ta vlerësojë apo dekorojë këtë figurë kaq të madhe. Nuk e di nëse dikush është kujtuar të shkojë tek i biri, nipi apo dikush që jeton prej familjes së tij për të shfletuar dorëshkrimet e tij. Sikur asgjë të mos ketë bërë Rexh Meta në jetë, veç fakti se ai ishte shqiptari i parë që është diplomuar në Kembrixh me medalje të artë, ai e meriton një shtatore në Tiranë. Për më tepër, të mos harrojmë se ai ka shoqëruar një nga gazetarët më në zë të botës për kohën që ajo jetoi, Rose Wilder Lane, e cila ka bërë për Shqipërinë në shumë



Rexh Meta

Rose Wilder Lane ndërhyr në SHBA

Por, gazetarja, shkrimtarja dhe antropologja Rose Wilder Lane, sapo e mëson këtë fakt, ndërhyr gjer te Presidenti i SHBA për t'ia shpëtuar jetën atij. Enver Hoxha pranon t'ia falë jetën Metës, por me kusht që Rose Wilder Lane, që kishte një prestigj dhe influencë të jashtëzakonshme në mbarë botën, të mos fliste kundër regjimit komunist në Shqipëri. Lane e pranon kushtin e, për rrjedhojë, Rexh Metës i falet jeta. Por ai mbahet në burg për shumë vite, e më pas në internim, derisa vdes diku në afërsi të Tiranës, në të njëjtin vit që vdes dhe Enver Hoxha.

se shumë e shumë shtetare shqiptare. Jeta e Rexhë Metës meriton të shkruset. Ashtu siç e meriton të rivlerësohet dhe vihet në piedestalin shqiptar që meriton Rose Wilder Lane.

Mendoj se Ministria e Kulturës bën më mirë të akordojë fonde për libra e dokumentarë rreth këtyre figurave të ndritura të historisë së Shqipërisë, sesa për ca programe televizive, libra apo aktivitete surrogate, të cilat nuk po i përmend me emër pasi nuk kam asnjë dëshirë apo nevojë të bëj armiq.



A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Akademia jonë e Shkencave është në një qerthull të madh, përballë disa platformave për të ardhmen e saj. Mes të tjerave, janë ato, të cilat i ka vënë përpara, struktura e drejtuar nga një prej punonjësve të saj më të vjetër Skënder Gjini dhe një platformë alternative e akademikut Artan Fuga. Qëllimi është i njëjtë, por qasja ndryshon kryekëput. Duket se është e nevojshme që Akademia të ndryshojë konceptin e organizimit dhe mbi të gjitha të bëhet e dobishme në zhvillimet e vendit. Për ta bërë këtë deri më tani janë ngritur disa grupe pune, por që të gjitha kanë mbetur sepse përballë është problemi i fondeve dhe mbi të gjitha letargjia që ka ndërthyer institucionet dhe vetë individët, që nuk gjejnë hapësirën e nevojshme për të punuar. Në disa momente, kur është dashur që akademikët dhe njerëzit e shkencës të përballnin argumente, ata i janë përveshur njëri-tjetrit në forma shumë armiqësore deri duke arritur edhe denigruar njëri-tjetrin.

Për ta thënë më qartë: Që Shqipëria është në këtë gjendje ekonomike-sociale-politike është një meritë dhe e këtij institucioni nga i cili është pritur aq shumë. Më e dhimbshme ka qenë futja e shtetit në procese të ndryshme të reformimit që kishin lidhje me të dhe mbi të gjitha artikullimi i kryeministrit të fundit të vendit Edi Rama për funksionalizimin e saj.

Në fakt, nuk është vetëm institucioni që mund të konsiderohet si fajtor, por edhe makutëria e shtetit tonë që Akademia e Shkencës pasi u reformua në vitin 2008, ia zhveshën të gjitha institutet që ishin në varësi të saj dhe ia denigruan krejt arkivat dhe databasë dhe e mbushën me militantë, duke e lënë me një grup akademikësh por pa asnjë strukturë mbështetëse. Kjo e fundit ndër-

Për ta thënë më qartë: Që Shqipëria është në këtë gjendje ekonomike-sociale-politike është një meritë edhe e këtij institucioni nga i cili është pritur aq shumë. Më e dhimbshme ka qenë futja e shtetit në procese të ndryshme të reformimit që kishin lidhje me të dhe mbi të gjitha artikullimi i kryeministrit të fundit të vendit Edi Rama për funksionalizimin e saj. Në fakt, nuk është vetëm institucioni që mund të konsiderohet si fajtor, por edhe makutëria e shtetit tonë që Akademia e Shkencës pasi u reformua në vitin 2008, ia zhveshën të gjitha institutet që ishin në varësi të saj dhe ia denigruan krejt arkivat dhe databasë dhe e mbushën me militantë, duke e lënë me një grup akademikësh, por pa asnjë strukturë mbështetëse

A do mundet reforma ta lëvizë Akademinë dhe a po vdes shqipja nëpër botë?!

lidhet me institucionet shkencore. Ish-kryeministri Berisha ka një rol aspak të mirë në humbjen e imazhit të këtij institucioni, pas zhveshjes që i bënte nga funksionet vartësit me bekimin e tij. Kjo bëri që ndër vite Akademia u kthye në një institucion për honorare dhe që ndihte akademikët të nxirrnin botime që duhet thënë se nuk e përfaqësonin si duhet këtë institucion. Mbi të gjitha institucioni bëri kuptimin e akademikut, atë imazh të rëndë që shqiptarët e identifikonin me korifejtë e shkencës shqiptare si Radovicka, Çabej, Xhuvani, Buda, Farudin Hoxha etj...

E vetmja gjë pozitive në ditët tona lidhet me faktin se debati mbi shkencën, respektin e strukturave dhe menaxhimin e saj përbën një kërkesë të kohës për t'i dhënë shtytë funksionalizimit të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shoqëror të vendit.

Megjithatë jemi shumë larg, të mjafton të shikosh reagimin e kryeministrit dhe postimin e tij për të kuptuar sesa të varur janë njerëzit e shkencës. Të vjen ndërmend kërcënimin me prejen e komplet fondeve, që të kuptojë se shpesh ata janë përdorur nga politika. Dhe, më shumë akoma, kërkimet bëhen nga struktura që punojnë, struktura që mungojnë në vendin tonë dhe shteti

asiston grupe shkencëtarësh që mund t'i bëjnë ato. Në një farë mënyre ka ardhur koha që të ketë një lloj demokratizimi sa i përket investimeve nga buxheti i shtetit.

Ndërsa të gjithë seksionet akademike janë në vështirësi, duket se albanologjia, një nga seksionet e saj më vitale, po përballon me çaste tejet të vështira. Mbi të gjitha nuk ka vizion realisht sesi do të jetë albanologjia e të ardhmes. Sikur vetëm një aspekt të marrim: Shqipëria mezi nxjerr dhe ka një grup përkthyesish të huaj, që e përçojnë produktin shqip në botë, por edhe ata janë të kufizuar prej gjuhës, mbështetjes financiare dhe mbi të gjitha përzgjedhjeve që bëhen. Ku mbizotëron trafari dhe një përzgjedhje tejet e dobët. Në këtë moment, Shqipëria nuk i ndihmon sepse është shumë e vështirë të ketë një bashkëpunim me të huajt, ndonjë lloj politike e cila ta inkurajojë sistemin e hulumtimit.

Përmenden shumë mungesat e fondeve nga strukturat e BE-së, por një gjë duhet ta kemi të qartë: Shqipërisë nuk i jepet edhe për faktin e thjeshtë se produkti i saj nuk përfaqëson ndonjë nivel që ia vlen sepse vetë albanologjia nuk ka hapësirë, ku të gëlojë debati shkencor dhe të mund të prodhojë tema të ndryshme të cilat janë të denja të

përballen me botën. Ndërkohë për ta kaluar debatin pak më poshtë shqiptarët po humbin gjuhën e tyre në diasporë. Kemi rastin e Malit të Zi me zonat që janë në kufi me Shqipërinë, ku kushtet e këqija ekonomike po i bëjnë shumë shqiptarë të Malit të Zi të emigrojnë dhe të shkretojnë vendin, që po zihet nga malazezët, ashtu si ndodh me ata të Preshevës e Medvegjes dhe për të mos thënë për laboratorin tonë të vërtet të gjuhës në Kalabri, ku situata pa shpresë i bën arbëreshët të ikin e të largohen. Njësoj po ndodh në Greqi, por këtu problemi është më kompleks sepse arbëreshët e Greqisë (Arvanitasit) kanë një strukturë të tyre mbrojtëse të gjuhës e me radhë. Shqiptarëfolësit po rrallohen dhe kjo është një tragjedi jo e pakët.

Çështja e Akademisë, albanologjisë dhe e gjuhës tashmë është një çështje kombëtare që bëhet me njerëz që kanë vizion por edhe përfaqësojnë shumë. Shkollat duan para, Akademia do para dhe albanologjia po ashtu, por një vend me këtë ritëm ekonomik nuk do mundet asnjëherë, për më tepër kur politika punon pa strategji kombëtare. Do jetë nëse e vështirë, paçka asaj që thuhet. Dhe, nëse ky debat i ri po bëhet që të tërheqë vëmendjen nga problematikat e vendit, atëherë në këtë rast të paktën ia ka arritur plotësisht qëllimit të vet.

M

MUZIKOLOGJIA

NGA DR. KRESHNIK DUQI

Kompozitori i parë që dha sinjalin e lindjes së artit të ri të kultivuar ishte Palok Kurti që kompozoi "Bashkimi i Shqipnis", Prenk Jakova ishte krijuesi i operas së parë "Mrika", Çesk Zadeja ishte autori i i simfonisë së parë shqiptare dhe Tish Daija ishte krijuesi i baletit të parë shqiptar. Ndër shumë emra të tjerë të njohur listës së kompozitorëve shqiptarë iu shtua dhe një emër shumë i rëndësishëm "Aleksandër Peçi".

PEÇI, ALEKSANDËR

Kompozitor shqiptar. U lind në Tiranë më 11 Korrik të vitit 1951. Pasi studion mandolinë në rrethet e Shtëpisë së Pionierit dhe në Shtëpinë e Kulturës në Sarandë, kryen studimet e para muzikore në Liceun Artistik J. Majsja, në degën e teoritikut, në vitet 1965-1969. Më pas, vazhdon studimet e larta për kompozicion pranë Institutit të Lartë të Arteve, në vitet 1969-1974. Në klasën e prof. Ç. Zadesë. Ka pasur një karrierë të pasur artistike dhe është nderuar me shumë çmime dhe tituj, njëri prej tyre është titulli "Artist i Merituar". Ka një repertor të larmishëm me veprat e krijuara. Është autor në të gjitha gjuhët e muzikës.

Ky autor shumë prej veprave të tij i ka krijuar duke u mbështetur mbi motive popullore të zonave të ndryshme, disa nga titujt janë:

Ndikimi i muzikës popullore në krijimtarinë e kompozitorit Aleksandër Peçi

"Dance Triste", është krijuar me motiv të marrë nga "Qan lulja për lulen", "Valle mbi xham", me motiv të marrë nga "Vallja Nr.1 e Tiranës", "Valle Rapsodi", me motiv të marrë nga "Napoloni", "Barokjare" me motive të Shkodrës, "Valsi i trëndafilave Shkodër", "Valle e Rugovës" Kosovë, "Vajzë e valëve" Himarë, "Fër fër për ja bën fustani" Korçë, "Fryn veriu" Korçë, "Valle Gorarçe" Korçë, "Valle brilante e Kolonjës" Kolonjë, "Valle e Pogonit", "Kroni i Zanave" Kosovë, "Beautiful flowers" Tiranë, "Tasti që lëshon xixa" Shkodër, "Arbereshe" Kalabri, "Lule borë" Shkodër "Sharki e ngjujar" Malësi e Madhe.

"Toka e Diellit" e cila u vlerësua me çmim të parë në festivalin e 28-të të këngës në RTSH, të vitit 1989, me motiv të këngës "Ç'po vejn lumi rrema rrema" Zall Bastar, "La shanson brise" Skrapar, "Rapsodi koncertante" Përmet, "Rapsodi Nr.1" Tiranë Valle e Pipzave, "4 vallet për violini e piano" Shqipëri e Mesme, "Rapsodi Nr. 2" Përmet, "Rapsodi Nr. 3" Shqipëri e Mesme, "Rapsodi Nr. 4" Dibër, "3 valle për cello" Përmet, motivi i ujkut të baleti "Kecat dhe Ujku", "Kater valle për violinë dhe piano", të marrë nga "Ditë e zezë, mre, dit' e hon", mre".

"Sonata Nr. 1 për piano" "The drama of birds" abstragim mbi struktura celulare e motiveve përmetare, "Sonata Nr. 2 per piano" "Argjiro" mbi struktura celulare e motiveve të polifonisë Gjirokastër, "Sonata Nr. 3" "Skënderbeu", "Sonata Nr. 4 për pi-



ano" "Kabacells" mbi struktura celulare e motiveve të kabave, "Sonata Nr. 8 për piano" "Megaondul" mbi struktura celulare e motiveve të malësisë së madhe përmetare shkodër kabave Përmet, "Sonata për cello" "Sonat e valëve pentatonike" labe me një vale pentatonike toske, "Sonata Nr. 7" "Spectralia" koha e dytë vale pentatonie nga jugu.

"Në emër të jetës" nga një strukturë kënge me sharki e Azis Ndreut Dibër, kjo këngë u vlerësua me çmim të dytë, fest 88, "Cartesius cantus Nr. 4" Bradasheh, "Cartesius cantus Nr. 11" maj krah, "Koncerti për piano Nr. 1" Karajfilat që ka Shkodra, kënga "Les Racines Sonores" nga kaba e Gjeneral gramafonit, "Megaision meg shtresor" (piano) Byzantine.

Tema të krijuara origjinale filmash shqiptarë mbështetur në intonacione nga: "Tokë e përgjakur" Përmet, "Gjeneral gramafoni" Përmet, "Kur xhirohej një film" Berat, "Në çdo stinë" Korçë, "Si gjithë të tjerët" Shkodër, "Dasma e Sakos" mbi kaba, "Një emër mes njerëzve" mbi Polifoninë "Kush vdes në këmbë" Jug. Disa nga këto tituj janë vlerësuar me kupa festivali dhe çmime ndërkombëtare.

Ky autor ka ditur të shfrytëzojë më së miri muzikën popullore duke krijuar vepra shumë të suksesshme me motive të mara prej tyre. Aleksandër Peçi është një nga figurat më të rëndësishme të muzikës klasike shqiptare bashkëkohore. Krijimtaria e tij është shumë e pasur dhe e vlerësuar si në muzikë klasike, muzikë filmash dhe këngë.

Më datë 8 gusht 2016, në konservatorin Tchaikovsky u luajtën 5 sonata të Aleksandër Peçit si: "The Drama of Birds" në tre kohë, "Skënderbeu" me nëntë kohë, "Spectralia", "Mouvement Contrarie" në tre kohë dhe "Chromaspectre and black hole" me një kohë.

Aleksandër Peçi ka në katalogun e tij 835 vepra të botuara, të cilat janë pasuri e madhe muzikore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shënime

1-Shupo, Sokol. "Enciklopedia e muzikës shqiptare", vëllimi I, Qendra për Dokumentimin dhe Komunikimin e Muzikës Rajo-

T

TEORI

NGA THANAS L. GJIKAJ

Vijon nga faqja 13

Trashëgimia homerike e sjellë shqip prej Ilia V. Ballaurit më për shtatjen shumë cilësore të materialit poetik dhe me shënimet, komentet, analizat, esetë dhe ilustrimet e shumta artistike, është befasuese në shumë aspekte. Ia vlen të përmendim këtu se ky shqipëruar vjen në fushën e artit të përkthimit nga bota e shkencave të sakta, ku njohuritë e tij për matematikën dhe fizikën janë për tu admiruar, si thonë ish-pedagogët e kolegët e tij. Pra ai gjatë shqipërimit të tekstit poetik ka respektuar saktësisht ritmin e metrikës homerike, duke e ndjekur atë përmes rrokjeve të gjata e të shkurtra, si do ta shikojmë më poshtë.

Thjeshtësia e këtij njeriu të ditur dhe punëtori të madh të bën për vete që në faqet e para të parathënies të veprave homerike. Kur ai fillon të tregojë për madhësinë e Iliadës, bën këtë apoloji: "... tek rreshtat që vijojnë në këtë parathënie për veprën e Homerit asgjë nuk është e imja, veçse puna për të krijuar mozaikun që do të lexoni, që siç do ta shihni, është një kolazh mendimesh dhe vlerësimesh në shekuj, për veprën e poetit të madh. Këto i zgjodha mes shumë të tjerash duke i konsideruar si më të veçanta. Ndërkaq, pranohet se çfarëdo që të thuash për Homerin, së pari, është gjithmonë e pamjaftueshme, së dyti, po të hulumtosh, do të konstatosh se është thënë më parë prej mendjeve të ndritura, dhe së treti, për të është thënë dhe shkruar aq shumë, sa një jetë njeriu nuk mjafton për t'i njohur të gjitha." (Iliada I.V.B. Parathënie, f. v).

Urtësia e I. Ballaurit po ashtu bie në sy që në faqet e para kur jep mesazhin e tij: "Iliada" është eposi i luftës, i grindjeve, i mërisë mes njerëzve, popujve.

Ia kushtoj këtë shqipërim, mirëkuptimit, paqes, qetësisë mes tyre - Duke na kujtuar në pupujve ballkanikë të ecim përpara drejt mirëkuptimit, paqes e qetësisë midis tonë.

Të shumtë janë mendimet dhe vlerësimet për Homerin nga shkrimtarë të mëdhenj, kritikë, specialistë, filozofë, filologë, personalitete, etj, të një harku kohor e gjeografik shumë të gjerë. Ballauri sjell afërsisht mendimeve të M. Arnold (kritiku më i njohur i Homerit për të gjitha kohët deri sot), të E. Hamilton (një prej helenistëve më të njohura po ashtu për të gjitha kohët), të J. Griffin, M. Adler, W. Gladstone, G. Flobert, Spiro Çomorës tonë, R. Graves, G. Leopardi, etj. Prej thënies elegante të këtyre mendimtarëve që vlerësojnë veprën e Homerit, të sjella në parathënie e Ballaurit, po ndalemi në dy prej tyre:

Gjatë jetës, sa më tepër kalojnë vitet dhe rritemi e moshohemi, interesat për një larmi në të lexuar, bien njëra pas tjetrës dhe kam frikë se do të mbetem vetëm me Homerin dhe Virgjinin, apo ndoshta vetëm me Homerin (Tomas Jefferson, Iliada I.V.B Parathënie, f. v).

Dua të lexoj Iliadën e Homerit në tre ditë, ndaj mbylle derën mirë me lloz(!), më dëgjoni, mbylle(!), dua që askush të mos m'la largojë vëmendjen, asgjë të mos më shqetësojë. Në të kundërt, të siguroj, të betohem, se atëherë ke për të parë, sesa rëndë, sa ashpër do të zemërohem" (Pierre de Ronsard, ose i quajturin prej francezëve "princi i poetëve" - drejtuar mëkëmbësit të vet, para se të

Shqipërimi i plotë i veprave homerike "Iliada" dhe "Odisea" me sfondin e tyre enciklopedik prej Dr. Ilia Vasil Ballaurit, përbën një ngjarje të rëndësishme për letërsinë, artin, kulturën dhe shkencat shqiptare. Kësaj arritjeje cilësore në të ardhmen do t'i kushtohen studime të shumanshme prej specialistëve të fushave të ndryshme, por unë do të sjell disa vlerësime për të pa pretendim shterues...


"Iliada" dhe "Odisea" të Homerit prej Ilia V. Ballaurit

Analizë mbi shqipërimet e poemave

lexonte Homerin (Iliada I.V.B. Parathënie, f. vii).

Poemat e Homerit konsiderohen krahas Biblës si veprat më të përhapura dhe më të lexuara në mbarë botën, që kanë luajtur një rol shumë të madh për orientimin e njerëzimit drejt qytetërimit dhe humanizmit. Iliada deri në vitin 2009 në anglisht, shkruan Ballauri, ishte përkthyer 78 herë, në frëngjisht 43 herë, shumë herë në gjermanisht, italisht, portugalisht, spanjisht, rusisht, etj. Madje disa herë edhe në disa gjuhë të Ballkanit, si në rumanisht, bullgarisht, serbokroatisht, etj (Iliada I.V.B. Vol.1 f. 169 - 173). E njëjta gjë, shton ai, duhet thënë edhe për Odisenë, në anglisht është përkthyer 66 herë deri në vitin 2014, në frëngjisht 26 herë, dhe shumë herë në gjermanisht, rusisht, italisht, spanjisht, portugalisht, etj, si dhe në gjuhë të Ballkanit (Odisea I.V.B. Vol.1 f. 190 - 195). Tek përkthimet e mësipërme për të dy eposet, gjejmë të gjitha format e vargëzimit si: heksametrik, jambik pentametrik, kuplete heroike, vargje të thyer, vargje të bardhë, prozë, soneta, me rimë, pa rimë, etj.

Shqipja është ndër gjuhët e fundit të kulturës europiane, ku u përkthye Homeri i



Përkthimi i kryeveprave

Krahas punës për të sjellë në shqip letrare vepra të letërsisë moderne europiane, ai shquhet edhe si njohës i thellë i botës së lashtë greke, veçanërisht i Homerit, Safos, Anakreonit (të cilët i ka shqipëruar të plotë), Platonit, Aristotelit, Hipokratit, Eskilit, Euripidit, Sofokliut, njohës i miteve, i historisë, gjeografisë dhe sidomos i shkencave të Greqisë së lashtë, për të cilat ka botuar disa libra, etj.

plotë. Në shqip Homeri i plotë u përkthye në vitet '60-'70, të shekullit të kaluar, pra më se gjysëm shekulli më parë.

Ballauri jep i pari një historik të shkurtër mbi përkthimin e Iliadës në shqip: Përkthimin në gjuhën shqipe të Iliadës së Homerit e ndeshim për herë të parë dhe vetëm për rapsodinë e 1-rë, në vitin 1896. Autori i përkthimit ishte Naim Frashëri. Botimi i saj u krye në Bukuresht prej shtypshkronjës së shoqërisë "Dituria" në formën e një fashikulli. Më pas kjo rapsodi u ribotua më 1912 në Korçë, nga shtypshkronja "Korça", titulluar: "Iliadë e Omirit, kthyerë Naim Be Frashëri". Po Naimi, më 1886, pra dhjetë vjet përpara se të kryente botimin e vet në shqip, pat botuar në turqisht, veç veprave të tij të tjera në këtë gjuhë edhe përkthimin e kësaj rapsodie të Iliadës...

Pas Naimit, At' Gjergj Fishta, i dyti pas Naimit, përktheu rapsodinë e 5-të, (fragment) të Iliadës së Homerit... Në vitin 1938, shtypshkronja françeskanë botoi rapsodinë e 22-të, të Iliadës së Homerit përkthyer prej Prof. Frano Alkaj. Botimi në fjalë në gegërisht, shoqërohej nga një përshkrim mbi poezinë epike greke të lashtë, të shkruar po nga përkthyesi. Më pas më 1941, F. Alkaj botoi tek, "Hylli i Dritës", përkthimin e rapsodisë së 24-të të Iliadës, po ashtu në gegërisht... Në një botim të viteve të fundit postmortum

janë ndryshe, kur në të ekziston edhe një përkthim i Iliadës në gjuhën e vet. Gjon Shllaku duke përkthyer Iliadën e plotë në shqip, jo vetëm që i solli vëndit këtë kryeveprë të pakrahueshme të letërsisë botërore por, ai me këtë punë, e mbuloi me një vello ndriçuese gjithë zhvillimin e letrave tek ne. Pa Homerin në shqip, nuk do të mund të thoshim: "Fishta është Homer". Një popull që nuk e njeh Homerin, edhe Kadareja nuk do të mund t'i thoshte: "Eskili ky humbës i madh", sepse një popull që nuk e njeh Homerin, është një humbës edhe më i madh.

2-Iliadën siç shihet më sipër, e zunë me dorë edhe penat më të mëdha të letrave shqipe por ata e lanë atë. Përsëri, ishte Gjon Shllaku i vetmi, ai i cili ia doli mbanë një pune të tillë, aq kolosale, aq të lodhëshme dhe aq voluminoze.

3- I përdjekur, nëpër burgje që në moshën të re, ai e përktheu Iliadën në atë kohë, kur ngado, imponohej dhe inkurajohej me forcë prej diktaturës së asaj kohe, të lexoheshin vetëm citatat e Mao Ce Dunit dhe veprat e Enver Hoxhës. Ai e përktheu Iliadën duke qënë në një izolim të plotë politik, shpirtëror, intelektual, burimor, ekonomik, etj, duke patur në dorë vetëm një armë, vullnetin dhe duke mos patur ndoshta as edhe letër, për të shkrujtur. Për mua që përkthimin e Iliadës së tij e kam ndjekur deri në qelizë, Gjon Shllaku mbi të gjitha, ishte një hero i letrave shqipe. (Iliada I.V.B. Vol.1 f. 174 - 175)

Mbas këtyre vlerësimeve për përkthyesin para tij të Iliadës, Ballauri sjell dhe historikun e përkthimit të poemës Odisea: Në bibliografinë e vëndit tonë përmendet se, prej Odisesë së Homerit ka patur përpjekje të hershme për të përkthyer pjesë të ndryshme, madje nënvizohet se i pari që mundi të përkthejë, të tre rapsoditë e para, të kësaj veprë madhore ka qënë poeti, publicisti dhe patrioti, Aleksandër Stavre Drenova - Asdreni. Me keqardhje pastaj shtohet se këto përkthime, mbetën si dorëshkrime të pa botuara. Ndërkaq i pari që mundi të nxjerrë në dritë një libër të botuar me Odisenë e Homerit, ka qënë Spiro Çomora por edhe ky jo të plotë por, vetëm me dymbëdhjetë rapsoditë e para, botuar më 1973, disa vite më pas para se botimi i Iliadës së përkthyer prej Gj. Shllakut. Odisea e Çomorës pat qënë redaktuar prej Andrea Varfit dhe garkulloi në atë kohë, me një tirazh tepër të madh 18 mijë kopje, vitin që ai vdiq! Spiro Çomora folklorist, satirist, shkrimtar, poet dhe komediograf, me origjinë nga Vunoj, ishte njëkohësisht edhe një helenist i shquar madje për mua edhe elegant. Ai përktheu një sërë veprash të Antikitetit, prej Ezopit, Aristofanit, Juvenalit, etj. Çomora punoi gjithashtu edhe në redaktimin e shqipërimit të Iliadës së Gj. Shllakut...

Përkthimi i plotë i Odisesë së Homerit, në Shqipëri është realizuar prej Profesor Pashko Gjeçit dhe u botua më 1976, pra rreth 10 vjet pas botimit të Iliadës... Pashko Gjeçi, poet, mësues, përkthyes, i njohur dhe i vlerësuar i solli vëndit, përveç Odisesë së Homerit

1- Në një vend evropian letrat dhe arti

it edhe shqipërimin e Komedisë Hyjnore të Dante Aligherit, si dhe një gamë të pasur shqipërimesh të tjera, mes të cilave edhe Faustini e Gëtes, Traviatën e Verdit, tragjedi të Jean Racine, etj.

Së fundi në vitin 2009, një tjetër përkthyes i sprovuar Lllambro Ruci nga Dhërmiu, solli një përkthim të dytë të plotë, të Odisesë së Homerit. Puna e kryer prej LL Rucit është e kujdesshme. Kuptohet, e kryer në një tjetër kohë, me të tjera mundësi dhe për rrjedhojë dhe me cilësi. Me shtimin e përkthimeve të Homerit, tashmë lexuesit i jepen mundësi të njohë më mirë poetin e lashtë dhe madhështinë e tij, i jepen mundësia për krahasime, thellime, studime, etj. (Odisea I.V.B. Vol. I f. 194 – 195)

Ndërkohë kur përkthyesit e mësipërm, sollën secili vetëm njërin prej të dy eposeve të Homerit, Gj. Shllaku - Iliadën, P. Gjeçi - Odisenë dhe LL Ruci po Odisenë, vlen të theksojmë se Iliada V. Ballaurit është i pari dhe i vetmi deri sot që shqipëroi gjithë veprën e Homerit me rreth 28 mijë vargje, që përbëjnë korpusin e plotë të poemave Iliada dhe Odisea.

Iliada (2013) e Ballaurit është një shqipërim në dy volume me gjithsej 959 faqe në format të madh A4, ose me rreth 1.900 faqe të librave me format mesatar; kurse Odisea (2017) në dy volume me gjithsej 753 faqe në format të madh A4, ose me rreth 1.500 faqe të librave me format mesatar. Kurse libri Mburroja e Akilit dhe kullmime të tjera të Iliadës së Homerit përbëhet nga 230 faqe botuar më 2013 me format mesatar. Së fundi një studim special tepër interesant, i realizuar dhe botuar vetëm në anglisht prej Ballaurit sivjet (2018) me titull *A mathematical mirror to reflect on Homer's Iliad and Odyssey vocabulary* (Studime matematike nën prizmin e linguitikës kuantitative për fjalorin Homerik) me 201 faqe A4 ose me rreth 400 faqe të formatit mesatar. Pra puna madhore e I. Ballaurit mbi Homerin i kalon 4.000 faqet.

Të dy epokset e Homerit janë shoqëruar me një plotësi shënimesh dhe riprodhim ilustimesh fotografike, pra me një sfond të pasur dhe voluminoz enciklopedik, gjë që siç thotë vetë ky shqipëruar, pa të, është e pamundur që poeti i madh të kuptohet e të shijohet si duhet. Mungesa e këtij sfondi do të ishte një gjë e ngjashme me dikë që hyn në një muze të panjohur, pa një guidë, pa një shpjegim për të kuptuar përmbajtjen e ekspozimeve; ose sikur të ngjallej sot dikush për kohëve homerike e të jetonte midis nesh pa e sqaruar atë për smartphonet, fekondimin extrasomatik, klonizimin, për wi-fi, microsoftword, etj.

Ky shqipëruar i talentuar dhe i mirëformuar në shumë aspekte shkencore e pati kuptuar që në fillim të punës së, pa u sjellë lexuesve sa më të gjallë botën e kohëve homerike, veprat e poetit gjenial nuk mund të shijoheshin, nuk mund të kuptoheshin dhe mbi të gjitha nuk mund të vlerësohej fakti pse Homerit mbetet për të gjitha kohët babai i poezisë dhe poeti më i madh që jetoi e krijoi në tokën tonë.

Në hyrjen e Iliadës, studiuesi Ballauri ka hartuar një ese për jetën e Homerit, mbështetur në biograficitë të të rëndësishme të shkruara për këtë poet prej Herodotit, Plutarkut dhe Prokllitit, si dhe në gojëdhëna e traktate të ndryshme.

Lidhur me kohën se kur jetoi poeti i madh, Ballauri shkruan se studimet e sotme shkencore filologjike mbështesin, përcaktimin e Herodotit, sipas të cilit autori i eposit të lashtë grek, jetoi rreth vitit 800 para Kr. Ai pranon dhe mendimin e Eratosthenit, i cili ka llogaritur se poeti jetoi 100 vjet pas Luftës së Trojës, kohë kur ishin konoliduar shumë këngë trimërie për bëmat e luftëtarëve të Trojës, disa prej të cilave Homerit i ka riprodhuar me gojën e rapsodit Dimodok gjatë gostisë që dha mbreti Alkino (Odisea rapsodia 8).

Përsa i përket origjinës së Homerit, Ballauri përmend dhe një epigram të lashtë ku shkruhet:

Shtatë vende hahen mes tyre, kush të njihet si rrënja nga ku rrjedh Homerit: Smirni, Hio, Kolofoni, Itaka, Pilosi, Argosi, Athi-

na.

Helenistët e sotëm grekë janë pajtuar me mendimin se Homerit lindi në Smirni dhe pasi shëtit në shumë qytete vijoi jetën në ishullin Hio, ku sipas Pavsanisë ndodhej edhe varri i Homerit. Në këtë ishull u zhvillua dhe tradita e Homeridëve (rapsodë që këndonin si Homerit poemat e tij) traditë e cila mbërriti e gjallë deri në kohën e Pindarit në shek. V-të para Kr.

Pavarësisht nga këto konkluzione, të cilat askush nuk mund t'i përmbysë, unë (Th. L. Gj.) mendoj se qyteti i origjinës së Homerit mbetet ende një problem i hapur dhe dua të sjell këtu mendimin e Prof. Dhimitër Pilikës, një tjetër helenist korçar. Ky studiues në një intervistë dhënë Prof. Muzafer Xhaxhiut rreth viteve 1991 – '92, dha disa mendime interesante lidhur me origjinën dhe vendlindjen e Homerit. Ai shprehu mendimin se Homerit ka shumë mundësi të ketë lindur dhe të ketë kaluar rininë në ishullin e Itakës, ishullin e Odiseut, ku u rrit me gojëdhënat, rrëfjet e legjendat mbi Odisenë. Këtë mendim ai e

e të cilave madje edhe me ngjyra. Aty-këtu jepen edhe statistika të lidhura me botën e veprave homerike apo edhe shtjellime për stilin e poetit të madh, etj. Veprat janë të pasuruara me një indeks shpjegues dhe të numërtuar të emrave që gjenden në vargjet e Homerit, si dhe me një bibliografi të pasur prej qindra referimesh.

Te ky korpus rapsodish shqipëruar prej Ballaurit gjenden dhe analiza të tragjeditë e komedive të lashtësisë, ku flitet se çfarë kanë huazuar prej Homerit në veprat e tyre dramatikë Eskili, Sofokliu, Euripidi, Aristofani, etj. Jepen po ashtu trajtime të shkencave dhe sidomos të astronomisë, astrofizikës, matematikës, fizikës, bujqësisë, lundrimit, etj. Ku thuhet sesi bazuar tek Homeri çfarë elementë përlogaritë pastaj shkencëtarët e lashtë si p.sh. Arkimedi, Eratosteni, etj. Veprat janë të mbushura me sqarime rreth filozofisë, psikologjisë, moralit, të drejtës, etnografisë, zakoneve, traditës të ligjëritimit rapsodik, etj, ku jepen pjesë nga Platoni, Aristoteli, Plutarku, Ovidi, Herodoti, Tuqididi, etj, që lidhen me varg-

mënyrën sesi përkthehet Homeri dhe për këtë sillen mendimet e koncentruara por edhe të zgjeruara të M. Arnold, J. Borges, J. Sheppard, etj. Jep historikun e përkthimeve të Homerit në latinisht, frëngjisht, italisht dhe anglisht ku kuptohet rëndësia edukative dhe admirimi sublim për poetin e madh prej kulturës dhe botës europiane. Shtron statistikaisht çështjen e fjalorit homerik bazë, duke sjellë të dhëna nga studiues akademikë; trajton temën e vargëzimit homerik, bazuar gjërësisht dhe me hollësi në një sërë studimesh shkencore, filologjike, matematike, muzikologjike etj. Trajtimi i vargut homerik prej Ballaurit, të mrekullon sesi një çështje kaq të thellë ai e sjell kuptueshëm dhe bukur. Gjithashtu ai trajton temën e shtresëzimit arkeologjik të Trojës sipas studimeve më të fundit, kronologjinë e luftërave të Trojës, jep analiza të armatimeve të përdorura, të numrit të mundshëm të luftëtarëve që mendohej të kenë marrë pjesë aty, të strukturave navale, etj. Sjell studimet dhe hipotezat si dhe planimetritë e mundshme të arkitekturës së ndërtimit të



arsyetonte me idenë se poetët në përgjithësi vendit ku janë lindur e rritur dhe njerëz të shquar të tij u kushtojnë vepra ose pjesë të rëndësishme të krijimtarisë së tyre. Pra Homerit duke thurur një poemë të tërë për Odisenë, duke i kënduar dashurisë së këtij heroi për vendlindjen, i ka kënduar dhe dashurisë së tij për vendlindjen e vet, pra ka zbuluar origjinën e tij të njëjtë me atë të Odisesë.

Edhe këtë hipotezë të Dh. Pilikës nuk duhet ta hedhim poshtë, përdërisa nuk ka fakte konkrete ku të jetë shënuar vendlindja e Homerit të madh... Nga ana ime shtoj, në të mbështetje të kësaj hipoteze, se Odisea në kompleksin e veprave homerike, është personazhi më i skalitur dhe më i dashur i autorit. Për karakterizimin e tij, Homerit ka përdorur më shumë epitetet vlerësuese se

jet homerike; flitet sesi Homerit i detyrohen poetët lirikë Pindari, Safo, Anakreonti, Theokriti apo edhe historiani Ksenofont, etj, madje edhe sesi Aleksandri i Madh gjatë fushatave të tij, admironte Homerin dhe zgjohet e binte të flinte me Iliadën e kopjuar prej Aristotelit, që e mbante nën kokë.

Krahas këtyre sqarimeve që jep I. Ballauri për Homerin që lidhen me ndikimin e poetit të madh në lashtësi, ky shqipëruar nëpër faqet e Iliadës dhe Odisesë jep gjërësisht dhe me hollësi, ndikimin e Homerit në epokën e kohëve të reja, si tek Danteja, Petrarka, Bokaçjo, dhe te figura të tjera të Rilindjes europiane si Galileo Galilei, Feneloni, J. Racine, te burri anglez i shtetit Lordi Granville i shek. 18-të, tek Alfred Lord Tennyson, madje dhe në ditët e sotme te G. Klimt (piktur simbolist), J. Borges, J. Joyce,

pallatit të Odisesë ku zhvillohet pjesa kryesore dhe më tragjike e ngjarjes së eposit; sjell studimet e disa universiteteve dhe NASA-s rreth përlogaritjeve të mundshme të kohës së ngjarjes së luftërave të Trojës bazuar mbi eklipsat e një periudhë disa mijëvjeçare, etj. Pra, me pak fjalë shqipëruari ynë i sotëm sjell një enciklopedi homerike të vërtetë, gjë që dhe ndër publikimet rreth Homerit në botë, mesa kemi parë, është e rrallë.

Por si janë organizuar të gjitha këto tek botimet e I. Ballaurit?

Për çdo rapsodi ka sqarime, komente, analiza, shënime, etj, të cilat jepen krahas vargjeve homerike, me poshtë-shënime ose anash-shënime dhe pastaj në fund të çdo rapsodie në disa faqe, jepen thellime për temat e ndryshme që treguan pjesërisht më sipër. Lexuesi i këtij korpusi poetik enciklopedik, ku teksti homerik është shqipëruar mjeshtërisht dhe shënime, sqarimet, esetë, ilustrimet dhe konkluzionet janë ndërtuar në nivel të lartë shkencor, nuk do të ndjej ngopje e lodhje duke përthithur vlerat e shumanshme artistike e shkencore të tij.

Valen të sjellim shembuj konkretë për ta bërë më të kapshme këtë arritje të Ballaurit.

Në një pjesë të shkurtër tek Iliada, rapsodia e 18-të, vargjet origjinale 483 – 489, ku flitet sesi perëndia Hefest, që jepet prej Homerit njëkohësisht edhe si artist, mjeshtër dhe farkëtar, përgatiti mburojën e re të Akilit, sepse mburojën e parë ia mori si trofe Hektorit mbasi vrau Patroklin që kishte veshur armët e Akilit. Kështu, Homerit tregon pra sesi perëndia Hefest e zbuluori gjithë art mburojën e re të Akilit në sipërfaqe, me një sërë pasqyrimesh të veçanta.

→ Vijn nga faqja 17

Po i riprodhojmë të dy variantet e shqipërimet prej I. Ballaurit dhe Gj. Shllakut:

...
E pra, mbi mburojë farkëtoi tokën dhe qiellin, detin dhe sipër tij, diellin.
Diellin që - u lodha, - kurrë nuk thotë, si dhe hënëzën dyllë të verdhë, të plotë. Gdhëndi pastaj, gjithë yllësitë, me të cilat qielli kurorëzohet,
Pleadet, Hyjadet, Orionin që për forcë dallohet,
si dhe Arushën e Madhe, yllësinë qiellore, që e quajnë me një emër të dytë edhe 'Karrrocë Hyjnore'.

Kjo, vjen në kupë sipër rreth e gark, në një vend, në një pikë, si roje, i rri Orionit të fortë, ndërsa vetë ajo nuk mund të ikë, të perëndojë, të zhduket, prapa tek ujërat e Oqeanit, të lahet, të futet. (shqipëroi: I. V. Ballauri, Iliada Vol. 2, f. 226)

...
Skaliti, Tokën, Qiellin edhe detin, hënëzën e plotë dhe diellin e palodhshëm, të gjitha yllësitë që i bëhen kurorë qiellit, Jadet e Shenjëzat dhe fuqinë e Orionit t'Madhen Harushë që edhe 'Qerre' e quajnë, e rreth një pike përgjithmonë vërtitet drejt nga Orionit dhe ndër gjithë yjet veç se ajo s'bie në ujra t'Oqeanit. (shqipëroi: Gj. Shllaku, Iliada rapsodia 18-të, vargjet 611 - 618)

Vetëm në këto pak vargje Homeri jep një kartografim të kupës qiellore për gjërësitë tona gjeografike, që pa një sqarim të tyre ato duken si të pakapëshme, si fjalë të një devijimi poetik dhe ndoshta për një lexim jo fort të përgjenduar edhe si një befasi pa lidhje që ndoshta duhet kapërxyer.

Në fund të këtyre vargjeve me një poshtë-shënim të gjerë, I. Ballauri sqaron domethënien e tyre. Së pari, mënyrën se si konceptohej fizikisht bota në kohët Homerike, madhësia, forma, shtrirja e saj, etj, dhe si imagjinohej në ato kohë kupa qiellore, cilët janë konstelacionet e Pleadeve dhe Hyjadëve si dhe Orionit, pse ky quhet i fortë, cili është pozicioni reciprok mes këtyre konstelacioneve, Arusha e Madhe, pse ajo quhet 'Karrrocë Hyjnore', pse ajo vjen përqark Orionit, pra i rri si roje, pse nuk perëndon në gjërësitë tona gjeografike. Sqarohet gjithashtu se si perëndimin e diellit në kohët homerike e imagjinojnë sikur ky shkonte e binte në Oqean, Oqean ky që rrethonte tokën pjatë të sheshtë dhe aty pasi dielli lahej gjithë natën dilte pastaj nga ana tjetër i pastër dhe fillonte përsëri punën e vet të ndriçimit të përditshëm të jetës mbi dhë.

Poshtë-shënimet janë një formë e zbërthimit që u bën ky shqipëruar vargjeve homerike.

Një formë tjetër sqarimesh e përdorur prej I. Ballaurit, janë dhe ansh-shënimet, të cilat rënditen anash tekstit poetik mbasi faqja A4 është shumë e gjerë dhe i mban për bukuri.

Po marrim si shëmbull përsëri një pjesë të shkurtër nga Odisea, rapsodia 10, vargjet origjinale 508 - 514, ku flitet sesi Kirki (ose Circea) e udhëzon dhe i tregon Odisesë rrugën, si ky të futet në botën e shpirtërave, të të vdekurve, pra të perëndisë Adi dhe të bashkëshortes së tij Persefonit, ku pastaj aty do t'i duhet të takojë shpirtin e mandit (profetit) Tiresia, i cili ishte i vetmi që mund t'i parathosë drejtimin, gjatësinë e rrugës dhe të udhëtimin, fatin pra që i rruhej, për të mbërritur në Itakë.

Po i riprodhojmë të dy variantet e shqipërimet prej I. Ballaurit dhe P. Gjeçit:

...
Ndërkaq, kur të kapërxeni Oqeanin, në një breg të ulët ndaloni,
ku është pylli i dendur i Persefonit, me plepa të gjatë, të bardhë dhe shelgjishte që varen, që frutat i rrëzojnë, i prishin,
aty pra ankorë anijen, në anë të Oqeanit



“Iliada” dhe “Odisea” të Homerit prej Ilija V. Ballaurit

Analizë mbi shqipërimet e poemave

me shtjella të forta, të thella që ujin e vërtitin,
prej nga ku pastaj, më këmbë ke për tu futur,
në të Adit vendbanim të vjetër, me lagështirë, të mykur:
Aty në Shkëmbi, përzihen dhe rrëzohen, duke buçitur prej oshëtimave,
tek lumi Akeron, i lëngimeve, i psherëtimave: si lumi tjetër Piriflegjethon, i zjarreve të pashuara,
ashtu edhe lumi Kokito i ftohtë, i vajtimeve me të rënuara,
që del si degë, e lumit Stiks. (shqipëroi: I. V. Ballauri, Odisea vol. 1 f. 279)

...
Me varkë më parë kalo oqeanin, e kur t'arrini ju te Kepi i Vogël, të pylli i Persefonës me akacie plot pemë pa jetë dhe me plepa t'largët, n'atë breg ndaloni anijen, ku përplasen rrymat e detit t'thellë. Atëhere ti merr rrugën drejt e te banesa e Hades. Njëpër moçal kalo gjer n'ato vise, ku Piriflegjetonin Akeronti e pret e ujrart që nga Stigia derdhen në Koçit brenda. Këta dy lumenj me shugullimë së bashku rrjedhin para Shkëmbit të Madh. (shqipëroi: P. Gjeçi, Odisea rapsd. 10-të, vargjet 613-624)

Në fund të këtyre vargjeve, I. Ballauri tek botimi i tij, në anash-shënimet jep sqarimet e hollësishme rreth topografisë së lashtë të botës së të vdekurve, sqaron gjeografinë dhe tonipomitet që përmënd Homeri më lart, ç'janë lumenjtë Akeron, Piriflegjeton, Kokito, Stiks, madje sjell këtu edhe një hartë të studiuësve të ndryshëm të kësaj pjese, por sidomos, sjell të përkthyer prej veprës së Platonit Fedho përkthimet mbresëlënëse të kësaj bote prej Sokratit (113a - 113c) para se ky të pinte helmin dhe të vdiste.

Ndërkaq lidhur me trajtimin e temave të ndryshme që përmëndem më lart në çdo fund rapsodie të Iliadës dhe Odisesë, duke lënë mënjanë larminë e tyre trajtuar prej I. Ballaurit, po përmendim vetëm njërin prej

tyre, atë që përse vargëzimi homerik është unik dhe nuk mund kurkush ta përsëritë atë, por përkthehet ose më mirë siç thuhet në shekuj perifrashet, në shumë lloj forma vargësh si heksametrik, jambik pentametrik, kuplete heroike, vargje të thyer, vargje të bardhë, prozë, soneta, me rimë, pa rimë, fjalë për fjalë, etj. Ballauri sjell tek Iliada (I.V.B. Vol. 2, f. 321-328) të dhënat e studimeve më të fundit të shumë autorëve, mendimet dhe konkluzionet e tyre. Ky punim është një ndërthurje, siç e thamë, e shumë njohurive dhe ndërkaq është e pamundur që të sjellim këtu dhe të trajtojmë atë që trajtohet aty, por për të krijuar sado pak një ide, po shkëputim disa rreshta prej këtij punimi interesant:

... Përpjekjet rreth sqarimit të vargut homerik, pra të mënyrës sesi Homeri e ka strukturuar vargëzimin e eposëve të tij, janë një 'luftë Troje' më vete. Në një anë qëndron kështjella, pra vargëzimi homerik dhe në anën tjetër heronjtë: kërkuesit, sh-

metrika, metrika e jashtme dhe e brëndëshme... Një varg homerik përbëhet prej gjashtë këmbësh, gjashtë masash, të cilat numërtohen prej 1 deri më 6. Secila prej masave mund të jetë ose daktilike ose spondike. Daktilik quhet ai metër që ka tre rrokje, mes të cilave, rrokja e parë është e gjatë dhe dy të tjerat janë të shkurtra, njësoj pra si edhe të tre kockat e gishtit tregues të dorës (grq. vjet. daktilos). Një metër daktilik (D) shënohet simbolikisht: - uu (rrokja e parë e gjatë, dy të tjerat të shkurtra). Muzikalisht shënohet: j& k&. Këtu rrokja e gjatë ka 1/4 e kohës, rrokja e shkurtër ka gjysmën e kohës së saj, pra 1/8, dhe gjithë daktilik ka 2/4 e kohës. Në formën e ritmit, ose të melodiozitetit, një metër daktilik do të tingëlloste, ose do të dëgohej, ose do të rrihte kështu: bum - pa - pa (pra rrokja, bum e zgatur, kurse rrokjet pa, pa, janë të shkurtra). Spondike (S) quhet ajo masë që ka dy rrokje, që të dyja të gjata e cila simbolikisht shënohet: --, muzikalisht dhe melodikisht a rit-

Ballauri bën një histori të botimit të “Iliadës”

Ballauri jep i pari një historik të shkurtër mbi përkthimin e “Iliadës” në shqip: “Përkthimin në gjuhën shqipe të ‘Iliadës’ së Homerit e ndeshim për herë të parë dhe vetëm për rapsodinë e 1-rë, në vitin 1896. Autori i përkthimit ishte Naim Frashëri”.

kencëtarët, teoricienët, që përpiqen ta marrin këtë kështjellë. Sqarimi i mënyrës së vargëzimit të eposëve të Homerit, kërkon një sërë djesh: së pari, njohjen e veprës së Homerit në thellësi, njohjen e vargjeve të tij në original deri në gërmë dhe në ton, njohjen e thellë të greqishtes homerike... njohjen e thellë të metrikës, të metrikës së lashtë dhe të krahasuar, njohjen e thellë të çështjes homerike dhe pastaj njohje edhe të teorisë së muzikës në tërësi dhe të muzikalitetit të gjuhëve të ndryshme, të lashta dhe të reja në veçanti, njohjen e statistikës matematike dhe sot të informatikës. Mbi të gjitha, duhet pastaj edhe imagjinata për të fantazuar sesi mundet gjithë këto njohuri të ndërthurin... Në vargun homerik që quhet edhe heksametri homerik, që është i ashtuquajtur i heksametri daktilik, studiohen dy

mikisht, bum - bum. Edhe këtu, njëra rrokje ka 1/4 e kohës, rrokja tjetër po ashtu 1/4, pra edhe metri spondik ka gjithsej 2/4 e kohës... Vargjet homerike, në masën rreth 72% të tyre, si tek Iliada ashtu dhe tek Odisea, janë:

A) 3 daktilë [9 rrokje] + 3 spondike [6 rrokje] = 15 = SSSDDDS, DSSDSS, etj; ose

B) 4 daktilë [12 rrokje] + 2 spondike [4 rrokje] = 16 = SDDDDDS, DSSDDDS, etj; madje së bashku me rastin
5 daktilë [15 rrokje] + 1 spondike [2 rrokje] = 17 = DDDDDDS.

Të tre këto lloj vargësh, zenë tek vepra e Homerit rreth 91% të gjithë vargjeve të tij. Nuk ka deri sot asnjë përkthim që të përsërisë koncentrimin e përmbajtjes së

eposeve në një vargëzim homerik në gjuhën që përkthehet, pra të veprave siç ligjëronte poeti i madh, ose që të paktën t'i përafrohet atij. Kjo gjë, sqaron Ballauri, vërtetohet sot edhe matematikisht. Mirëpo me gjithë këtë mund të themi se shqipërimi i këtyre dy veprave poetike duke respektuar rritimin përmes rrokjeve të theksuara e të pathek-suara, duke i sjellë në një shqipe poetike në vargje të thyer me 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16 dhe rrallë në 18 rrokje që rimojnë shpesh herë, mund të quhet një shqipërim me vlera origjinale.

Mënyrën sesi ky shqipëruer e ka sjellë në shqip Homerin, e përkthruan me hollësi që në fillim si tek Iliada (f. xvi) dhe tek Odisea (f. xii). Punën e vet ai e ka realizuar duke kryer studimin paralel dhe të krahasuar të tekstit origjinal, duke pasur përpara të hapura tekstin në greqishten e vjetër, pastaj në atë të re në disa variante akademike, në anglisht në disa variante nga më të vlerësuarit, në frëngjisht në disa variante po të tillë, në italisht e njëjta gjë, si dhe përkthimin ekzistues në shqip. Për Iliadën ka pasur përpara 13 Iliada në gjuhët që thamë, ndërsa për Odisenë ka përdorur 15 Odise në

Gjeçi, Ilija vë në dukje se pati fat, mbasi gjysmën e dytë të jetës, e jetoi në botën e lirë, në epokën e zhvillimit galopant të teknologjisë, të bumit të informacionit, të shkrimeve, të komunikimit, të imazhit, etj, të cilën ai e shfrytëzoi për bukuri si përdorues i shkathët i teknologjisë kompjuterike.

Së treti, ndryshe nga përkthyesit para tij, të cilët punuan shumë vjet në kushte të burgjeve mizerabël të kohës së diktaturës, I. Ballauri ka pasur fatin që prej tre dekadash po jeton në Greqi, ku ka vizituar shumë muze, disa herë Akropolin, ka shkuar në Itakë në atdheun e Odisesë, në Olimp, në vëndbanime të lashta, tempuj, në gërmadha antike, ka parë mure ciklopike, mbishkrime, mozaikë, kollona, arkada, skulptura e buste, ka ndjekur në amfiteatra të lashtë, që ende dhe sot funksionojnë, interpretime të tragjedive të antikitetit, pra ka thithur aq sa ka mundur atë cka mbetur sot prej Greqisë së lashtë.

Ndërkohë, këto përparësi, thotë ai, kanë pasur dhe anë negative të tyre. Gj. Shllaku dhe P. Gjeçi jetuan në një kohë, kur jeta e njerëzve, nuk kish televizor, internet, ko-

u ul, e kapi atë me duar tek gjunjët e forta, i puthi duart, ah, ato duart të tmerrshme lyer gjak, që u trembej gjithë bota, duar njerëzvrasëse, me të cilat ai, kaq e kaq djem plakut, i vrau, i mbaroi, e pra këto duar, ai i puthi, i shtrëngoi. Dhe njësoj siç ndodh, me një njeri, që s'është në vete dhe në vendin e vet, vret komshinë dhe për të shpëtuar, ikën, merr arratinë, ikën, ikën dhe mbërrin, në një vend të huaj, largohet dhe hyn në një shtëpi të pasur të strehohet, ku të gjithë me të habiten, c'është ky lloj mik, e pra kështu dhe Akili, u habit. U habit tek shihte aty Priamin, mbretin e nderuar plak, përpara të gjunjësuar, u habitën edhe të tjerët, njëri tjetrin shihnin të hutuar. Dhe ja, plaku iu lut: 'Akil, ti që me hyjnitë përngjason, kujto atin tënd,

në këtë botë, duke puthur me gojë, me buzë, dorën e atij njeriu të fortë, që më vrau fëmijët.' Këto ishin fjalët e Priamit, të shprehura gjithë dhimbje, aty i gjunjësuar dhe ja, prej shpirtit të Akilit tashmë të prekur thellë, të trazuar, u ndez, shpërtheu dhembshuria, dhe kështu, u shkreh në vaj, në të qarë. E kapi, plakun për duarsh dhe lehtë-lehtë, ato nga gjunjë ia largoi, pastaj të dy, sekush plagët e veta të zemrës kujtoi, Hektorin trim njëri dhe qante, e derdhte lotët uje, përpara vrasësit të tij, shpërtheu me kujë, mbledhur kruspull, aty tek këmbët e Akilit. Ndërsa tjetri, ky herë qante, derdhte lotë për atin e vet, herë-herë për Patroklin, që më nuk ishte në këtë jetë.

Kështu pra vajet, dënesat e tyre aty brenda në shatore, u ndezën, morën qiellin gjith' brenga e klithma mortore, por kur Akili hyjnor u ngop, me lotë së qari, u ngrit prej fronit ku ish ulur dhe më këmbë atypari, përpiquej që edhe plakun ta ngrinte, duke treguar bashkëdhimbje, me atë kokë dhe mjekër të bardhë, të thinjur dhe kështu pra, tekta përpiquej për ta ngritur,

i tha këto fjalë: 'Eh, o at fatkeq që shpirti kaq fort të vuan, vetëm një forcë e madhe të ka shtyrë, të vish i vetëm këtu, tek anijet e Akejeve që me rreptësi, një ushtri e tërë i ruan, të vish këtu përpara meje, ballë për ballë, me mua sy ndër sy, me atë burrë që kaq djem të vrau, që të nxu jetën ty.

E pra duket se ke zemër të fortë, të hekurt. Ulu! Hidhërimin për njerëzit e vdekur, le ta gëlltitim thellë, thellë, në të shpirtit shpellë. Nuk del gjë prej dhimbjes së helmuar, sepse perëndia e amëshuar, fatin e njeriut, kështu e ka caktuar, në dhimbje dhe helm të jetojë, të qajë, të vuajë, të drithërojë.

Dy gypa ndodhen, në prag të pallatit të Zeusit, prej të cilëve dhurata, nxjerr dhe jep ky zot, njëri gyp me vuatje, fatkeqësi, dhe tjetri, me të mira plot.

E pra, Zeusi që argëton me shkrepëtimat, të cilat, i hedh nga qielt e lartë, dikujt ia jep të përziera këto dhurata dhe këtij pastaj, si t' i vijnë këto, ashtu edhe i ndodh, herë e gjen e keqja, dhe herë e gjen e mira, i shkon jeta mbroth. Por kujt i jep dhimbje, vuajtje, fatkeqësi, e bën të poshtërohet si njeri, të cilin mjerimi shkatërrues, e ndjek, i shkon pas ngado që të vejë, qetësi mbi dheun e shenjtë, të mos gjejë, pa vlerë dhe pa nder, si ndaj perëndisë, por edhe i përbuzur prej njerëzisë.' (shqipëroi: I. V. Ballauri, Iliada Vol. 2 f. 432-433)

Askush prej tyre s'vuri re kur hyri Priami i madh që u hodh në këmbët t' Akilit, e me krahë gjunjë ia shtrëngoi e i puthi ato duar t' tmerrshme dhe gjakatara, që i vranë aq djem edhe i lënduan shpirtin. Porsi një burrë që e ndjek kobi i shëmtuar, kur vret ndonjërin në atdhe e mërgohet në dhe të huaj, dhe n'shtëpi i futet një pasaniku ku të gjithë habiten; ashtu u çudit kur pa Akil Pelidi Priamin hyjnor, dhe u çuditën tjerët, dhe shoku-shokun me habi vështronin. Duke iu lutur, kështu Priami i foli: "Babë ke dhe ti, o Akil, pinjoll i Zeusit, plak siç jam unë në buzë të zezë të varrit.

Por unë i mjeri që në Trojë vigane bëra sa djem të gjithë të pikatur, s'di a më ngeli ndonjë gjallë prej tyre. </



gjuhët e mësipërme. Ndërkaq sipas të dhënave që jepen prej tij, tek bibliografia, krahas qindra titujve të paraqitur aty, ai ka shfrytëzuar 16 lloje botimesh të Iliadës dhe 21 botime të Odisesë, nga më të vlerësuarit, në gjuhë nga më të ndryshmet. Gjithashtu, ka shfrytëzuar bibliotekën e vet të pasur me disa mijra volume. Edhe më, si na tregoi gjatë diskutimeve me të, ai ka shfrytëzuar edhe internetin, për të konsultuar fjalorët më të pasur të gjuhës së vjetër greke, fjalorët homerikë, fjalorët mitologjikë, historikë, gjeografikë, etnografikë, enciklopedi të ndryshme, etj. Ka shfrytëzuar po nëpërmjet internetit, bibliotekat më kryesore të botës, punime shkencore, publikime, simpoziume, etj dhe ka raste thotë ai, që për shëmbull, për një fjalë ndaj të cilës përkthyesit kanë marrë qëndrime të ndryshme i është dashur të studiojë dhe të lundrojë në internet me ditë, për të vendosur edhe ai se ç'qëndrim duhej të merrte.

Duke e pyetur për rrethanat dhe konditat që e ndihmuan tek arrijtjet e tij, krahasuar me shqipëruerit shqiptarë të mëparshëm, Ilija tregon pa mburrje se, krahas ndihmës së palodhur dhe nxitjeve të bashkëshortes, zonjës Elisabeta, ai ka pasur dhe tre përparësi të tjera:

Së pari, shqipërimet e veprave të Homerit, Gj. Shllaku dhe P. Gjeçi i bënë shumë a pak rreth moshës 40 vjeçare, ndërsa unë, sqaron ai, i fillova pas kësaj moshe dhe i përfundova kur isha rreth 67 vjeç. Specialistët e botës së lashtë greke, bien dakort se korpusi homerik kuptohet, ndjehet dhe shijohet më tepër në gjysmën e dytë të jetës së njeriut, gjë që e pati kuptuar edhe Jefferson-i, të cilin e përmëndëm më lart.

Së dyti, ndryshe nga Gj. Shllaku dhe P.

mpjuter, celular, facebook, makina, lëvizje, etj dhe kur libri ishte gati gjithçka, sidomos në vëndin tonë. Në këtë aspekt koha kur I. Ballauri solli punët e tij nuk e favorizoi atë, madje ai e di dhe është i ndërgjegjshëm se sot pak kohë kanë njerëzit e përkultur mbi smartphone e facebook, që të lexojnë ato cka ai ka punuar në gjysmën e dytë të jetës së tij.

Gjithashtu Ballauri, duke qënë i larguar dhe i harruar për shumë kohë prej vëndit, është i panjohur për qarqet promovuese në Tiranë, i paqushëm në arenën e brilleve aty. E është një outsider dhe për rrjedhojë jashtë loje. Siç e ka thënë edhe vetë diku në një shkrim, as edhe thëndlindja e tij (Korça) nuk ka kohë të merret me volumet e tij për Homerin, mbasi kanë problemet për festat e lakrorit e të birrës.

Së fundi, për të krijuar edhe një ide sa më të qartë rreth vargjeve homerike të shqipëruara prej Ilija V. Ballaurit, po sjell këtu një ndër pjesët më kulmore të Iliadës, rapodia 24 (Vol. 2 vargjet origjinalë 477 - 487; 493 - 505), takimin e Priamit me Akilin. Mbreti Priam, natën në errësirë i larguar fshehtas prej Trojës së rrethuar, i shoqëruar vetëm prej mëkëmbësit të vet, mbërrin tek fushimi i Akejve dhe futet fshehurazi në shatorin e Akilit. Jemi pra në gastin kur plaku i lutet heroit, që t'i japë kufomën e përdhunuar të të birit, Hektorit.

Le t'i këndojmë këto vargje në të dy variantet Ballauri - Shllaku. Themi t'i këndojmë, sepse vargjet homerike nuk duhen lexuar si vargje poezish të thjeshta, ato duhen kënduar si vargje këngësh: Priami i madh, hyri në shatorre dhe ata nuk kuptuan gjë, pasi i qëndroi përpara Akilit, pa bërë zë,

që njësoj si dhe mua, mosha e pleqërisë e mundon, shkallët e vështira të viteve që ngjitim, derisa të ikim.

Dikur linda djem trima, të fortë që s'i kish njeri, këtu, këtu në Trojën me rrugë të gjëra madhështore, dhe më të shumtit prej tyre, m'i rrëmbeu vdekja mizore. Kisha plot pesëdhjet djem, kur erdhi ushtria me Akej. Nëntëmbëdhjetë, m'i kish lindur e njëjta grua, ndërsa të tjerët, gratë e pallatit që fjetën me mua. Shumicës prej tyre, Ari luftëshpërthyes gjunjët u preu, ndërsa atë që ish,

i veçantë prej mua, që mbronte qytetin, që me ju e mprehu, e pra atë, ti para pak ditësh ma vrate, tek luftonte për atdheun e vet, Hektorin dhe vatrën më thave. E pra, për këtë po vij tani këtu, tek anijet e Akejve të paguaj, të lutem për kufomën e tij, të stërpaguaj, aq shumë dhurata sa edhe unë, dot s'i numëroj.

Akil, respektoi perënditë, ki mëshirë dhe për mua, tek më sheh në këtë ditë, atin tënd e kujto, madje unë jam edhe më fatkeq, ja shih, mendo, u përkula, dhe u përula aq shumë, sa asnjë njeri tjetër

...nga numri i shkuar

"Milaso" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Shkrimi kryesor iu la një argument të sjellë nga Qerim Vrioni, studiuesi i njohur i fotografisë. Autori duhet vlerësuar për vazhdimësinë, por mbi të gjitha pasionin e tij, që e ka kanalizuar ngushtësisht me fotografinë dhe historinë e saj. Rrëfimi në këtë numër ishte i jashtëzakonshëm dhe i kushtojë njëri prej fotografëve tanë të njohur të gjysmë të parë të shekullit të shkuar, Kolë Maca, veç profesionit, botoi në shtypin italian të kohës, pra mbi 100 vite më parë, dy artikuj mbi Shqipërinë të shoqëruar edhe me foto të tija të karakterit dokumentar, historik, etnografik, gjeografik, social etj. Shkrimet janë publikuar në faqet e "Revista Mensile del Corriere della Sera" (Revista e përmuajshme e Corriere della Sera) me emrin Kol Mazza 1907:1 ago, fascicolo 8, dhe me Kol Mazza-1908: 1 mag, fascicolo 5, pra i pari në 1 gusht 1907 dhe i dyti në 1 maj 1908, në një largësi kohore prej 8 muajsh nga njëri-tjetri. Autori e theksonte rëndësinë sepse botimi ishte bërë të "Corriere della Sera" (Milano), organi i cili prej numrit të parë në vitin 1876, vazhdon ende sot të mbetet një nga gazetat më serioze, më ndikuese dhe më jetëgjata në shtypin e shkruar në Itali (tashmë edhe në internet, online).

Kurt Gostentschnigg na kish sjellë nëpërmjet Ardian Ndreçës një shkrim, ku albanologu i huaj përshkruan një ekspeditë në malesinë tone në bashkëpunim të ngushtë me disa kolegë albanologë. Shkrimi ishte hartuar mrekullisht në gjuhën tonë, por redaktorit i ka shpëtuar një gabim, që autori e kishte pikasur vetë falë skrupulozitetit të vet. Megjithatë ankësen e tij ishte i kënaqur me botimin.

Rexhep Ferri vjen pas pak javësh me një esë në stilin e tij të zakonshëm, ku shprehet pesimizmi për jetën dhe shtëpësimi për identitetin shqiptar. Nga inati më vjen të them: Liria qenka nëna e të gjitha luftërave, shprehet akademiku i njohur Rexhep Ferri në një nga esetë që e ka përcjellë enkas për "Milasoa". Mundimi më i madh i tij është për të treguar përmes fjalës kaosin që e ka ngritëyer qenien shqiptare dhe që e mban

fort shtërnguar. Ai nuk tutet të tregojë mërzinë, frikën dhe konfuzionin e tij të madh... për këtë mjedis që kanë krijuar shqiptarët dhe e cila po kthehet në armikun më të madh të vetë shqiptarëve.

Poesitë e Stevan Raičkoviq janë përcjellë të propozuara nga shkrimtari dhe studiuesi Agim Vinca. Ai flet me nderim për poetin, por ndërkohë na ka sjellë të shqipëruar mrekullisht një pjesë të tyre. Dhe realisht disa nga poezitë e tij janë të mrekullueshme. Vinca i donte të botuara këtë javë, sepse kishte mundësi të blente Gazetën Shqiptare, e cila përcillej në Strugë.

Sul Gragjevi, në formatin e tij të zakonshëm, solli me një artikull fillimin e sezonit operistik amerikan, me një shfaqje të njohur të repertorit, që ka filluar më 26 shtator e vazhdon deri më 6 tetor, ku të pasionuarit e muzikës lirike do të shohin në skenën e tempullit operistik të Nju Jorkut operën "Aida" të Verdit. Krahas sopranos superstar Anna Netrebko, në rolin e Aidas, në skenë do të jetë Anita Rachvelishvili për Amneris-in; ndërsa Aleksander Antonenko do të interpretojë rolin e Radames-it. Në podin e dirigjimit do të jetë Nicola Luisotti. Redaktori për ko incidencë e ka ndjekur shumë Netrebkon, që ka qenë shpesh bashkë-interpretuese me baritonin e ndjerë rus, Dmitri Hvorostovsky.

Vetë redaktori shtoi një shkrim për teatrin për të cilin ka qenë i angazhuar me shkrimet e tij për ta mbrojtur godinën e vet, duke bërë një analogji me kinema "17 Nëntorit". E, fadromat që janë nisur drejt teatrit nuk kanë kohë të presin, ato duan ushqimin e tyre, që në këtë rast është godinë e teatrit, që me shumë gjasë jo shumë kohë më vonë, do të kujtohet jo më shumë se godina e kinema "17 Nëntorit". Por, ka ende dhe pak kohë. Mbasa në këto segmente të pakta kohore do të kthehet mundësi që të gjykohej që t'i besohet sensibilitetit të njerëzve, kundrejt makutërisë së kullave, që nuk dinë të ndalen... Redaktori e vlerëson shumë punën e mirë të layout në këtë numër, që duhet thënë se punoi me të gjithë angazhimin e vet.

Autori ka ngritur një alegori të këndshme duke përdorur mitologjinë dhe duke e njësuar me kohën tonë, një mënyrë jo e zakonshme që na sjell ndërmend letrarët e njohur të hapësirës përtej kufirit tonë... Autori është shumë iu kursyer me teknikën e tij në tregim, që na e përshfaq si një rrëfimtari të përgatitur mirë në këtë gjini

PROZA

Njeriu që i privatizoi pellazgët hyjnorë

NGA SALIBYTYÇI

Edhe ai donte të privatizonte diçka. Në valën e fundit të privatizimeve, kish-te arritur të merrte pjesë në garë, po, për fatin e tij të keq (fati i keq e kishte shoqëruar gjithë jetën), nuk kishte arritur të privatizonte gjë. Edhe një tokë që ishte më shumë gurinë dhe që as edhe dëllinjat s'i rritte, nuk arriti ta privatizonte, se një person nga Drenica, që vërshtirë ishte t'ia dalloje gjininë, burrë apo grua ishte, po edhe racën, thua se në qenien e tij ishin gërshtuar të gjitha racat: sy të gjelbër, lëkurë të zezë, flokë të verdhë, në momentin e fundit ia mori.

Doli jashtë nga salla i mërzitur dhe, shkoi qiellin: ndjeu në fytyrë ajrin..., i shkoi mendja, po ajri nuk privatizohet.

Çfarë të privatizonte, si të kthehej në shtëpi pa privatizuar diç, kur çdo gjë po privatizohet, dhe, në këto mendime i lindi një ide: pellazgët hyjnorë, ata ende nuk i kishte privatizuar kush...

Pasi nuk kishte konkurrentë, sepse ata që privatizonin nuk ishin njerëz të ngritur dhe nuk u kishte shkuar mendja të privatizimi i pellazgëve, Kostandin Th. i privatizoi.

Tanimë ndihej si të ishte jetë e njeri. Me ditë të tëra ikte nga kjo botë dhe kalonte në pronën e tij, ku koha dhe hapësira nuk kishin fund. Fliste me njerëzit e asaj bote, që ishin burra e gra me pamje më të bukura se ato të skulpturave antike greke, vizitonte qytetet e asaj bote, të ndërtaur krejt me gurë mermeri, shihte ujërat e kristalta që gërshtoheshin me pallatet e bukura, e gjelbërimi i përtjeshëm. Natyra u jepte frute me shije të rrallë, që edhe të ushqenin, po edhe të jepnin forcë e kënaqësi. Në pyje, kishte hapësira të veçanta në të cilat bletët thithnin nektarin dhe prodhonin mjaltin. Nuk kish nevojë për koshere, sepse ishin disa drurë të veçantë që, natyrshëm, kishin zbrazëtrira në të cilat bletët vendoseshin dhe prodhonin mjaltin.

Kostandini po kënaqej me jetën e re që po bënte tani.

Gjatë rrugës takonte perënditë pellazge me të cilat bënte ndonjë bisedë ashtu, sikur të ishin rritur bashkë. Për habi, të gjithë e njihnin! Dhe gjuha ishte e njëjta me atë që e fliste. Nuk kishte dy q/q dhe dy gj/xh, si ajo e Kongresit të Drejtshkrimit të 72-shit, po ishte shumë më e lehtë, fjalët sikur dilnin vet. Pinte mirë me ta dhe në rastet kur ndonjëri thoshte ndonjë qyfyre, krste gaz, nga i cili ushtonin malet.

Megjithatë, kënaqësia e tij nuk ishte e plotë, sepse që nga koha që kishte arritur



në vendin e pellazgëve hyjnorë, nuk i kishte rënë të takonte Zeusin!

Patjetër që do ta takonte një ditë dhe një ditë kishte marrë rrugën për të shkuar në Selinë e Zeusit, që gjendej në Malin e Tomorit. Rruga në atë hapësirë nuk kishte lodhje. Sikur e barte një shpend i padukshëm në krahët e vet, aq i lehtë ishte udhëtimi nëpër Dheun e pellazgëve hyjnorë.

Po sikur t'ia zinte vendin Zeusit, i shkrepë nëpër mendje.

Po së pari ta shihte, i tha vetes, pastaj... Në këto mendime e sipër e pa veten afër një tempulli madhështor, ndriçimi i të cilin nuk e linte ta shihte qartë pamjen.

Hyri në të dhe për habi, rojë nuk kishte kund. Arriti deri në pjesën më të lartë të tij, në të cilën ishte një sallë e madhe të cilën e mbanin shtylla ari, në mure stolisur me piktura dhe në të me skulptura perëndish, që nga Kronosi e këtej.

Froni i Zeusit ishte bosh, pra i zoti, Zoti i zotave, nuk qenka këtu.

Kërkoj nëpër tempull derisa gjeti një qenie që ishte mes njeriut dhe zotit, të cilin e pyeti ku gjendej i zoti i shtëpisë. Dhe

qenia iu përgjigj me gjakftohtësi se Zeusi tani ishte duke përjetuar një nga aventurat e tij të përditshme me ndonjë çobaneshë mali apo nimfë deti.

Besthëm kenka Zeusi, i shpëtoi nga goja kur syrin e kishte të fronit i Zeusit. Pse s'ia zë fronin kur ai lodron lart e poshtë me femna, dhe drejt e në fronin e Zeusit shkoi. U ul në të. Sikur nga poshtë i vinin disa djeqe, por pas një kohe u rehatue mirë në të.

Pasi pushoi, thirri qenien dhe i dha urdhër ta mbyllte tempullin me shul

Tani jam unë Zeusi këtu!, i tha atij.

Qenia kokulur e zbotoi urdhrin e tij.

Zeusi mbeti jashtë, i harruar në aventurat që po i bënte çdo ditë. Gjithësia tani kishte mbetur në dorën e Kostandini Th., ai tani sillte shiun, diellin dhe rrufetet e kishte në dorë.

Nga fronin i Zeusit shihte çdo gjë mbi tokë, bile edhe buburrecat kur bëheshin bashkë në punën e tyre fisnike. Me një gisht mund ta rrafshonte një mal, apo një qytet të fortifikuar. Me një rrufe mund të godiste kë të dojë dhe kur të dojë. Ndonjëherë për pikë të qejfit godiste një popull

dhe pastaj kënaqej kur, pasi të përfundonte goditja, populli mblidhej dhe i sakrifikohte vajzat më të bukura për të fituar mëshirën e tij.

Por, nuk mund të mos kthehej ndonjëherë edhe në kohën tonë, të kthehej në shtëpinë në kodër, të shihte njerëzit e vet. Kishte mall për çdo gjë të kësaj bote, sidomos nuk mund të rrinte tri ditë pa e rrahur gruan, të cilën e donte shumë. Përbehej se ajo ishte dashuria e jetës së tij, por se edhe tri jetë po t'i kishte prapë do ta donte atë. Por edhe do ta rrinte. Kuptohet, nga dashuria.

Jo rrallë përvidhej nga tempulli i Zeusit dhe kthehej në shtëpi, e digte dashuria ritin e lashtë të rrahjes së gruas. Të bërtiturat e gruas dëgjoeshin në lagje, po sa më shumë që bërtite grua, aq më shumë heshtnin fëmijët.

Ndërsa kur kthehej në pallatin e Zeusit për malllohe për gruan, e digte dashuria për të. Dhe një ditë, u bë pëllumb. I hapi dritaret e tempullit...

Gjatë fluturimit, në tokë shihte gra të bukura, me flokë deri në fund të këmbëve, me gjinj që t'i verbonin sytë, shihte nimfat të detit e zana të malit, po Kostandini ishte besnik, nuk e tradhtonte besën që ia kishte dhënë Dudisë së vet. Kur arriti afër shtëpisë, iu afrua dritares së dhomës, ku Dudia po i rregullonte çejzin e vet, dhe pa një pa dy, i fluturoi në gjoks. Dudia e hutuar u dorëzua, ndërsa Kostandini, tani i kthyer në Zeus, po ia hiqte rrobat një nga një. Kur e shtrëngoi me duart e tij të fuqishme, nga kënaqësia, Dudia filloi të bërtiste në kupë të qiellit. Fëmijët, po edhe lagja, i dëgjuan piskamat e Dudisë, po nuk bënë zë.

Kur e kreu aktin seksual me Dudinë, gati sa s'po fluturonte edhe kështu siç ishte, por prapë u kthye në pëllumb dhe doli nga dritarja. Në atë moment, kur nuk kishte asnjë re, u dëgjua një krsimë që tronditi vendin dhe u pa edhe një pëllumb që ra i coftë në tokë.

Gjatë rënies nga qielli në tokë, u dëgjua një zë si "Z's", po ata që ishin afër më shumë e morën si cicërimën e fundit të pëllumbit që u godit nga rrufeja.

Pëllumb i bardhë në qiell, tani në tokë ishte krejt i zi.

Opinioni

i Ditës

Demokracia liberale përballë nacionalizmit dhe interesave imperiale

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... botërore. Përveç aktorëve e faktorëve tashmë të njohur, si terrorizmi ndërkombëtar, aventurizmeve politike, qeverisjeve të dështuara autoritariste e diktatoriale, hendexeve të thella në zhvillimet ekonomike e sociale mes rajoneve të ndryshme në botë, krizave ciklike ekonomike, por edhe krizave politike e konfliktet me burim e përmbajtjeje etnike, apo të problemeve të pazgjidhura, avancimi i interesave imperiale nga aktorë në rritje, thellimit të pabarazive ekonomike, sociale e rajonale, një problematikë shqetësuese konstatohet brenda hapësirës perëndimore. Një grindje brenda Perëndimit, në vend që të hyjë në rrugën e trajtimit të vëmendshëm e zgjidhjes, po i fryn mendësisë së ndarjeve, kontradiktave dhe principit "secili rrugën e vet". Natyrisht që vetëvendosja e popujve është princip demokratik, siç është e drejtë e tyre të respektojnë historinë, zakonet e traditat e tyre, por modeli demokratik i zhvillimit ekonomik, politik e social ka rëndësi të veçantë. Dhe modeli perëndimor sot përfaqëson formën më të avancuar të zhvillimit, me gjithë problematikën që e shoqëron. Edhe pse modeli perëndimor është sot më i avancuar, ka dimension real e funksionues demokracinë e sundimin e ligjit, ndjen nevojën e perfeksionimit të tij. Çështja e përmbajtjes së lirisë e të drejtave të njeriut është shumë e pasur dhe një liri e vërtetë mund të mendohet kur të mundësohet kalimi nga sundimi i sendeve mbi njeriun, në sundimin e njeriut mbi sendet.

Sot konstatohet fenomeni që nacionalizmi e sovranizmi, apo trysnia në rritje e interesave të shtetit-komb, po nxit mbylljen e po i kundërvihet bashkëpunimit e integritimit, madje ka prirje t'u hapë rrugë tensioneve dhe kjo ndodh në një kohë kur mbi kokën e stabilitetit botëror qëndron si "shpata e Demokleut" një rrezik i shpërthimit të një krize të re botërore ekonomike e financiare, më e rëndë se ajo e vitit 2008. Brenda kësaj problematike evidentohet edhe një kundërvënje në rritje ndaj demokracisë liberale, lirisë e të drejtave të njeriut, sistemit të vlerave, demokracisë funksionale e sundimit të ligjit, globalizmit e multilateralizmit. Ka sot jo vetëm një rritje të ndjeshme të kundërvënies e goditjes së demokracisë liberale, lirisë e të drejtave të njeriut e sundimit të ligjit, por edhe një prirje për të krijuar aleanca brenda hapësirës perëndimore, por edhe me aktorë përtej saj. Modeli perëndimor i zhvillimit, duke e bërë funksional sistemin e vlerave e demokracinë liberale, mbrojtjen e lirisë e të drejtave të njeriut, e bëri shoqërinë e botën e sotme më moderne, e bëri modelin për ta ndjekur e sendërtuar. Modeli komunist pretendoi



t'ia rrëmbente këtë flamur Perëndimit, duke shfrytëzuar edhe diskretizimin e modelit perëndimor nga dalja në vitet '30 të shekullit të kaluar, të monstrave të nazizmit e fashizmit, por dëshitoi dhe u rrëzua. Demokracia liberale u avancua dhe u fuqizua, duke funksionuar realisht. Demokracia liberale krijon realisht hapësirë për funksionim normal të institucioneve demokratike, për sendërtimin e standardeve demokratike, për mundësimin e mbrojtjen e lirisë e të drejtave të njeriut, të lëvizjes së lirë etj., por krijon hapësirë, brenda vetes për kundërvënësit ndaj saj. Kundërvënja demokratike apo kritika nga brenda saj e fuqizon, e korejton, nxit ndryshimin e përsosjen, e ushqen demokracinë liberale. Megjithatë, ajo krijon hapësirë edhe për goditjen nga brenda të saj, për motive e interesa krejtësisht kundër funksionimit të saj. Është fakt tashmë që realiteti demokratik në hapësirën perëndimore i krijoi mundësi një lloj kritike e rebelimi ndaj elitave liberale në hapësirën perëndimore, që u ushqye edhe nga strategji nga jashtë perëndimit, që përgatitën programe konkrete luftime ndaj demokracisë liberale. Kështu, në proces, por edhe nën ndikimin e ndjeshëm të krizës botërore e financiare të vitit 2008, dhe si pasojë e disa dështimeve të politikave liberale, ekonomike e financiare, u mundësua një shtrat konkret për kundërvënësit ndaj demokracisë liberale dhe rritjes së dallgëve të nacionalizmit e populizmit. Shpirti apo mendësia protektive, mbyllëse, u dhanë lëndë sovranizmit e qëndrimeve kundër demokracisë liberale.

Sot është fakt që brenda hapësirës e modelit perëndimor ka qëndrime, lëvizje e veprime konkrete, që i kundërvihen në mënyra të ndryshme demokracisë liberale, sistemit të vlerave, funksionimit të demokracisë e institucioneve të saj, zhvillimit e mbrojtjes së lirisë e të drejtave të njeriut. Nuk është çështja për ekzistencë të koncepteve apo zakoneve që kanë frymëzime jodemokratike, por për veprime e platforma, që janë në kontradiktë të hapur me

demokracinë liberale, thelbin, përmbajtjen dhe funksionimin e saj. Tashmë është fakt i njohur jo vetëm debatimi, por edhe fillimi i procedurave ligjore nga strukturat e BE ndaj disa dukurive e praktikave, që lidhen me sundimin e ligjit, funksionimin e demokracisë e mbrojtjen e të drejtave të lirisë e të drejtave të njeriut ndaj dy vendeve anëtare të BE, ish-pjesë e kampit socialist.

Ajo që tërheq vëmendjen e që tregon agravimin e situatës sa i përket respektimit të standardeve demokratike e të sistemit të vlerave, është jo vetëm një kundërvënje të vendosur e adresim kritikash ndaj strukturave të BE nga ato vende, por tash konstatohet edhe një solidaritet nga pozicione nacionaliste e sovraniste brenda BE ndaj tyre jo vetëm nga vende të ish-kampit socialist, por edhe Italia. Përballimi i krizës së refugjatëve, që është realisht edhe një armë gjeopolitike kundër BE e modelit të saj të zhvillimit, vuiri në provë të plotë marrëdhënien ndaj sistemit të vlerave dhe demokracisë liberale. Ajo ndihmoi të dëshmohej se sa kanë avancuar prirjet e qëndrimit nacionaliste e sovraniste e që i kundërvihen kështu integritimit, sistemit të vlerave e projektit evropian. Në fakt në gjithë hapësirën evropiane nacionalizmi e sovranizmi ka prirje jo vetëm kundërvënës, kryengritëse ndaj strukturave të BE e marrëveshjeve të dakordësuar, por edhe sa i përket sistemit të vlerave e ardhmërisë së projektit evropian. Madje sot konstatohet prirja për t'u organizuar e dakordësuar në qëndrimet kundërvënës, ku duket që po u vinë në ndihmë edhe "specialistë" nga jashtë hapësirës evropiane. Nacionalizmi e populizmi në hapësirën perëndimore është bërë një fenomen endemik, që po e godet e gërryen nga brenda sistemin e vlerave, institucionet demokratike e në tërësi modelin perëndimor. BE po goditet nga brenda për interesa nacionaliste, populiste e sovraniste, nga forca separatiste, fenomeni "exit", ekstremizmi i djathtë etj. Është vërtetë tronditëse që politikantë antiemigracionit, nacionalizmi i djathtë, një

kundërvënje ndaj respektimit të sistemit të vlerave po bëhen pronë edhe e një pjesë të intelektualëve dhe sidomos e rinisë.

Qytetarët evropianë e duan demokracinë liberale, veçanërisht ato që ajo u mundëson e përfitimet konkrete, që i mendojnë si të drejta të përhershme e të pacenueshme dhe duket se konstatohet një shkuajdesje tronditëse për fatin e demokracisë liberale. Kjo shfaqet konkretisht, teksa nuk ka reagime nga poshtë ndaj goditjeve që po merr demokracia liberale e institucionet e saj, por edhe në faktin që është rritur numri i qytetarëve, që mbështesin në zgjedhje platformat nacionaliste e sovraniste, që hapazi i kundërvihen sistemit të vlerave dhe funksionimit të demokracisë e sundimit të ligjit. Kjo shkuajdesje apo një mosnjohje e problematikës konkrete ka mundësuar rritjen e peshës dhe rolit të partive nacionaliste, populiste dhe antieablishment në hapësirën e BE. Aktualisht, as partitë politike që rivalizojnë për të fituar zgjedhjet, por as edhe organizma joqeveritarë e sidomos sfera akademike, shkencore dhe intelektuale nuk po reagojnë, nuk po ndihmojnë në njohjen sa më mirë të së vërtetës, që po zhvillohet, si pa u vënë re. Vazhdon kështu fenomeni që qytetarët të bëhen pre e mashtrimit dhe e vetëm mashtrimit nga partitë politike, qofshin të vjetra, qofshin të reja. Nuk ka aktualisht ndonjë program konkret të detajuar për përballimin e problemeve të mprehta, të rritjes ekonomike e përballimit të problemit shqetësues të papunësisë, apo për rishikimin e sistemit të taksave, për rritjen e mirëqenies në të gjithë strukturën sociale të shoqërisë e për zbutjen e pabarazive sociale, që kanë prirje të thellohen; për përballimin e problemit tepër të mprehtë e të rrezikshëm të emigracionit dhe lëvizjen e popullsisë. Është fakt se pushteti i korporatave monopoliste është fuqizuar në rrugën e kërkesave të ligjeve ekonomike të ofertës, kërkesës dhe fitimit maksimal.

Nuk ka as studime e ndonjë ide për perspektivën e zhvillimeve ekonomike, sociale e demografike, për perspektivën e shtresave e kategorive konkrete sociale. Pushteti i zmadhuar i korporatave në një farë mënyre ushqen autoritarizmin dhe të liderëve politikë. Zhvillimet më të fundit dëshmojnë se modeli perëndimor sot ka hyrë në fazën apo ka pjekur nevojën e një reformimi serioz, që të mos lejojë të futet në një krizë të pakthyeshme, që do t'u hapte rrugë formave radikale të ndryshimit. Polarizimi i mëtejshëm i shoqërisë krijon mundësi e ushqim për radikalizmin e goditjen e mëtejshme të demokracisë liberale. Kjo nevojë reformimi e gjithë modeli i shërben modelit perëndimor, por njëherësh i shërben të sotesme dhe të ardhmes së njerëzimit, stabilitetit botëror e sigurisë në botë.

Në shkallë botërore problemi i lirisë e të drejtave të njeriut po bëhet një çështje më shumë e mprehtë. Jeta e lirisë e njeriut kërcënohen seriozisht nga faktorë komple-

ksë, natyrorë, por edhe ekonomike, politike, sociale. Jeta dhe liritë e njeriut kufizohen e goditen jo vetëm nga qeverisje autoritariste, eklektike e diktatoriale, por edhe nga format e terrorizmit e racizmit, nga thellimi i prapambetjeve të mëdha ekonomike, sociale e kulturore. Sot evidentohet zgjerimi i hapësirës e vëllimi i dhunës edhe shtetërore, që ka nxitur edhe shpërthim të krizave të refugjatëve e të emigrimit. Pikërisht kriza e refugjatëve dhe emigracioni po përdoren sot edhe si armë gjeopolitike kundër hapësirës perëndimore. Demokracia liberale dhe modeli perëndimor po sulmohen me intensitet edhe nga jashtë për interesa imperiale e gjeostrategjike. Është fakt i pamohueshëm që si Rusia, ashtu dhe Kina e dëshirojnë një grindje të Perëndimit, ngjece të avancimit të projektit evropian. Ato, duke pasur modele zhvillimi që ndryshojnë qartë nga ai perëndimor, nuk e mirëpresin një funksionim normal të demokracisë liberale në hapësirën perëndimore. Ata e kuptojnë mirë efektin në vendet e tyre të ndikimit të modelit perëndimor, të mbështetur në sistemin e vlerave, të funksionimit të demokracisë e mbrojtjen e lirisë e të drejtave të njeriut. Mediat kanë evidentuar edhe një mbështetje konkrete ndaj partive nacionaliste, populiste e euroskeptike në hapësirën perëndimore. Tashmë është i njohur problemi apo shqetësimi i ndërrhyrjes së Rusisë në zgjedhjet presidenciale të SHBA-ve, edhe pse investigimi vazhdon dhe Rusia e monon dhe që tash, përmes presidentit Trump, bëhet publike edhe një përpjekje e Kinës për të ndërhyrë në zgjedhjet amerikane, që gjithashtu është mohuar nga Kina.

Si nga Rusia, por edhe nga Kina vihen re edhe përpjekje për të servur argumente "teorike" mbi atë që e quajnë fund të demokracisë liberale, për fundin e Perëndimit etj. Duke parë edhe një rritje të dallgëve të nacionalizmit në të gjithë hapësirën perëndimore, mendohet se ka ardhur koha e rindinjes apo e ringjalljes nacionale. Një luftë tregtare SHBA-Kinë po i jep ushqim dhe argument Kinës e të tjerëve që të pohojnë se, veçanërisht SHBA-të janë kundër globalizmit, ndërsa Kina e mbron atë. Në fakt, globalizmi ka avancuar e ka pasuruar përmbajtjen e vet, madje është bërë edhe më i strukturuar e i rregulluar përmes rregullave e organizmave konkretë si OBT etj. Kontradiktat e shfaqura janë tregues i nevojës për ndryshime e përsosje të domosdoshme. Në një situatë të zhvillimeve botërore, që po bëhet më komplekse, kur nacionalizmat e radikalizmi shumëngjyrësh bëjnë presion në rritje ndaj demokracisë, sundimit të ligjit, mbrojtjes së lirisë e të drejtave të njeriut e zgjerimi i hapësirës së dhunës e shkeljeve flagrante të lirisë e të drejtave të njeriut po rrit valën e zemërimit të revoltimit, merr rëndësi të veçantë mbrojtja e përsosja e mëtejshme e modelit perëndimor të zhvillimit.

Opinion *i* Ditës

SPAK, si miti i breshkës me Akilin!

Nga Ben Andoni


(vijon nga faqja 1)

... po aq i vështirë në sqarim. Në konceptimin e Zenonit, një lëvizje e një aksh subjekti bëhet e pamundur nëse distanca e tij ndahet pafundësisht në segmente më të vogla. Një genie e cila mendohet se ecën shumë herë më shpejt se breshka nuk mund ta arrijë kurrë. Kështu, Akili, qenia gjysmë-mitike nuk do ta kapte kurrë breshkën, nisur para tij, pasi para se ta kapte, i duhej të arrinte në vendin ku ndodhej breshka para se ai të fillonte vrapin, pastaj në vendin ku gjendej ajo gjatë kësaj kohe dhe kështu në infinit.

Në muajin shtator të vitit 2018, shumë nga optimistët dhe patetikët mediatikë parashikonin të vinin arrestimet e para në vend. Madje kishin edhe emrat *gati*, që fill pas pushimeve verore, do u vëshinin prangat. Në kalkulimet e tyre, kandidatët për KLGJ e KLP do ishin zgjedhur dhe kjo do të thoshte që kryetari i Gjykatës së Lartë, me tagrin e tij, do duhej të thërriste mbledhjen e gjyqtarëve, ashtu si Kryeprokurorja e Përkohshme do të thërriste Këshillin e Prokurorëve. Nga këto mbledhje do të kishim respektivisht nga 6 kandidatë secili, pra 6 për KLGJ dhe 6 për në KLP. Në parashikimin më të mirë, ky proces shënonte ngritjen e gjykatave dhe strukturës antikorrupsion (SPAK). Ëndrra mbaroi sepse fatkeqësisht, tashmë që shtatori është mbyllur, procesi i rivlerësimit për subjektet e listës prioritare është ende në proces. Puna e KPK-së ka rifilluar me ritmet e breshkës së Zenos, pasi është zhvilluar vetëm një seancë dëgjimore, ndërse ende s'është publikuar kalendari i seanceve për periudhën në vijim, gjatë së cilës priten ritme më të përshpejtuara të procesit të rivlerësimit.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) zhvilloi seancën e parë dëgjimore në 21 mars 2018, duke vijuar procesin për afërsisht 5 muaj deri në datën 3 gusht 2018, datë në të cilën është zhvilluar edhe seanca e fundit për këtë sezon deri në fillimin e punës së komisionit në shtator 2018. Numri i seanceve dëgjimore ka pasur një kurbë rritëse deri në korrik, për të mbetur sërish në shifra gati të papërfillshme nga gushti deri në ditët tona. Në mars, prill, maj ka pasur respektivisht 1,5 dhe 2 shqyrtime, kurse në qershor, korrik respektivisht nga 10 dhe 28 për të zbritur sërish me një rast në gusht, referuar Buletin Informativ të Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

Mjaftojnë këto të dhëna të kuptosh se Reforma në Drejtësi ka ende shumë e shumë udhë për të bërë, por gjithashtu kjo e vendos në kalenda dhe të ashtuquajturin veting në politikë. Kjo sepse për të realizuar të gjithë procesin dhe për ta goditur në themel korrupsionin dhe krimin politik, duhet ngrit-



tur Prokuroria Speciale. Kjo strukturë, që tashmë përsëritet rregullisht në emisionet televizive dhe kudo me akronimet SPAK, jo vetëm që ka pak mundësi të ngrihet në pak ditë në vijim, por nuk ekziston qoftë edhe një parashikim optimist se kur do të realizohet, pasi plot dy vjet nga miratimi i të vetmit ligj të pranuar me konsensus të paketës së Reformës në Drejtësi, gjërat po lëvizin si në paradokset e Zenonit. Vetëm në ato koncepte mund të shpjegohen pengesat dhe më shumë akoma habitë që ndjekin reformën tonë. Këtë e kupton edhe se një përgjigje se kur do ngrihet SPAK mungon edhe nga qeveria 'Rama'.

Struktura e Posaçme Antikorrupsion (SPAK) duhet të kishte nisur nga puna plot një vit më parë, ose më saktë më 31 gusht 2017, kohë e cila konform parashikimeve ligjore shkonte me afatin e 300 ditëve nga miratimi i ligjit. Por, që SPAK-u të niste veprimtarinë e saj dhe të vendosej pikërisht në mjediset ku sot gjendet e lokalizuar Prokuroria e Gjykatave e Krimineve të Rënda, duhej të formoheshin dy subjekte: Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë i Gjyqtarëve. Me pak fjalë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi i vetëm kompetent që emëron prokurorin e posaçëm të SPAK.

Ky afat i tejkaluar me një vit dhe për shkak të ecurisë së proceseve të tjera që e kushtëzojnë krijimin e tyre, ka pak gjasa të realizohet edhe deri në shtatorin e vitit 2019. Një fakt është i pakundërshtueshëm: krijimi i gjykatave të posaçme dhe SPAK-u janë të pakthyeshme dhe do të vijnë, pavarësisht vonesave. Megjithatë, krijimi i shpejtë i tyre nuk është i domosdoshëm vetëm për të luftuar korrupsionin dhe krimin e orga-

nizuar, por edhe për të kontribuar në garantimin e integritetit të proceseve të tjera të Reformës në Drejtësi dhe moskapjen e tyre nga korrupsioni që në hapat e para, citojmë Buletin e Informativ të Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Deri më sot, procesi i rivlerësimit të subjekteve reja të mosngjritjes së organeve të reja të drejtësisë për shkak të vonesave dhe mosplotësimit të numrit të kandidatëve dhe kriterëve ligjore, ka sjellë edhe mosfunksionimin e disa prej organeve ekzistuese më të rëndësishme të sistemit gjyqësor në vend siç janë dy gjykatat kryesore, Gjykata Kushtetuese dhe e Lartë.

Të konsideruara si subjekte prioritare për t'u nënshtruar procesit të rivlerësimit, më shumë se gjysma e anëtarëve të këtyre institucioneve nuk kanë marrë nga komisioni konfirmimin në detyrë. Në këtë mënyrë, 3 nga 5 anëtarë janë shkarkuar nga Gjykata Kushtetuese (3 anëtarëve u ka përfunduar mandati dhe 1 është dorëhequr) dhe 5 nga 9 anëtarë të Gjykatës së Latë nuk janë konfirmuar gjithashtu. Për ironi, Gjykata Kushtetuese është tashmë jashtë funksionit, në pamundësi të shqyrtojë ndonjë çështje apo të pranojë ankesa nga qytetarët apo institucionet.

Gjendja është shqetësuese, pasi asnjë zgjidhje nuk është ofruar ende për daljen nga ngërçi i krijuar, duke sjellë në këtë mënyrë një boshllëk ligjor krejt të rrallë në vend. Akoma më shqetësues mbetet fakti që edhe e vetmi nga organet e reja të krijuara rishtazi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) është ballafaqur me një situatë të ngjashme. Edhe këtu, njësoj, moskonfirmimi në detyrë

i anëtarëve të institucionit ka sjellë mosfunksionimin total të tij. KED është institucioni i parë që u krijua në kuadër të Reformës në Drejtësi (dhjetor 2017) dhe roli i tij është mjaft i rëndësishëm për kompetencën që ka ky këshill në vlerësimin e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese, referuar Buletin Informativ të Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

Shpresohet se ky paradoks i vonesës së reformës do të përshpëtohet, pasi Shqipëria është në stadin final për hapjen e negociatave në qershor, ku ka si kusht themelor reformën, që ndërlihet direkt me ngritjen e KLGJ dhe e KLP. Këto janë dy hallkat që do ngrënë Strukturën e Posaçme Antikorrupsion dhe Byronë Kombëtare të Hetimit. Ngritja e KLGJ-së, e KLP-së dhe e SPAK-ut do të ndryshojë strukturën e drejtësisë shqiptare, ku Ilir Meta s'do jetë më kryetari i KLD, pasi institucioni do të shkrihet. Ashtu si edhe Arta Marku s'do jetë më në atë post, pasi si kryeprokurorë ka mandat të përkohshëm, pra deri në ngritjen e KLP.

Paradokset e Zenonit pasuan përgjigjen e Aristotelit për këtë argument që tregoi se vetë lëvizja nuk është as e ndashme, as e konceptueshme në terma hapësinore; ajo konsiston në kalimin e kufirit hapësinor, pra lëvizja është një realitet cilësor që ndihet dhe realizohet, por që nuk mund të paraqitet në mënyrë racionale. Vetëm se Reforma jonë në Drejtësi, sado të kufizohet dhe të ngadalësohet do të përfundojë sepse është një realitet që do të paraqitet në mënyrë racionale.

(Gazeta Shqiptare)

HOROSKOPI

DASHI
Dita e duhur për të nisur stërvitjen fizike. Do ta kenë të vështirë të kontrolloni emocionet gjatë ditë së sotme, por përpiguni të mos i irritoni njerëzit rreth jush. Do të jetë shumë e vështirë për ju të qëndroni larg partnerit/partneres suaj.

DEMI
Do të ndiheni të tensionuar, sidomos gjatë mbrëmjes. Megjithatë mos u shqetësoni, pasi do të përjetoni edhe momente të lumtura, shumë të rëndësishme për ju. Ka gjasa që të përballeni me disa keqkuptime me partnerin/partren tuaj.

BINJAKET
Ka gjasa që të irritoheni nga sjellja e anëtarëve të familjes suaj. Përpiguni të mos humbisni kontrollin, pasi mund të përkeqësoni situatën. Bëni kujdes me investimet! Nëse keni ndërmend ta bëni një gjë të tillë, duhet të mendoheni mirë.

GAFORJA
Do të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore, pavarësisht një axhende të ngarkuar. Ka gjasa të shqetësoheni për shëndetin e fëmijës suaj. Përpiguni të kuptoni nevojat e të tjerëve, para se të merrni ndonjë vendim të rëndësishëm.

LUANI
Shkathësia juaj do të bëjë që të zgjidhni disa probleme afatgjata. Shmangni personat që iu afrohen vetëm për interes gjatë ditës së sotme. Sa i përket lidhjes romantike, do të kaloni një ditë fantastike.

VRIGJERESHA
Do të ndiheni shumë mirë si fizikisht ashtu edhe nga ana mendore, pasi do të përjetoni momente shumë të lumtura. Mund të jepen mundësi shumë të mira për të fituar para. Përpiguni të mos ndërhyri tek çështjet e të tjerëve, pasi mund të krijoni një situatë të sikletshme.

PESHORJA
Kushtojni më shumë rëndësi shëndetit se sa jetës shoqërore. Ka gjasa të zbuloni një sekret, i cili do t'ju befasojë. Do të angazhoheni maksimalisht ndaj disa personave që iu kanë ndihmuar vazhdimisht.

AKREPI
Gjatë ditës së sotme ka gjasa që të nervozoheni për shkak të aktiviteteve të shumta. Njerëzit rreth jush do t'ju japin shpresë dhe do t'ju bëjnë të ëndërrori, por humbet varen nga ju. Shmangni shqetësimet e tepërta dhe përkushtojuni partnerit/partneres suaj.


SHIGJETARI
Sot do të ndiheni të relaksuar dhe do të keni dëshirë të artoheni sa më shumë. Përpiguni të mbani nën kontroll gjendjen financiare dhe të kufizoni shpenzimet. Ka gjasa që ngarkesa në punë të ndikojë negativisht në marrëdhënien me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

BRICJAPI
Përpiguni të mendoni pozitivisht dhe të jeni optimist. Do të bëni disa ndryshime në arredimin e shtëpisë, çfarë do t'ju blokojë një pjesë të ditës. Lidhja juaj romantike po bëhet gjithnjë e më interesante dhe intensive.

UJORI
Do të keqkuptoheni me një mikut tuaj, që që do të shkaktojë reagime të pakëndshme. Përpiguni të përmirësoni pozitën tuaj si në shtëpi, ashtu edhe me miqt. Sot mund të përjetoni momente të pahurshme me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

PESHQIT
Gjendja juaj financiare nuk do të jetë ajo që prisni. Disa ndryshime në jetën tuaj do t'ju prekin shumë emocionalisht. Komunikimi me personat që ju besoni më shumë do të ishte zgjidhja e duhur. Dëgjoni këshillat e të tjerëve, nëse doni që t'ia dilni mbarë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë një arkë.
8. Fillojnë ndeshjen
9. Paul që këndon Diana.
10. Spagna që këndon ën Itali.
13. Fillojnë lojën.
14. Gjysmë tepsie
17. Mund të jenë ekspres.
18. Qe babai i mjekësisë.
21. Eshhtë si ballon.
22. Lind një në kokë.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Një pjesë e edukatës.
27. Inicialet e Asimov.
28. Eshhtë e vrara në kufhtë.
30. Iglit te Lazio.
31. Inicialet e Redford.
33. Mbetet në fund.
34. Pak analogji.

35. Eshhtë vdekje e autorizuar.
39. Një numër femrash.
42. Në krye të modernistëve.
43. Kërkojnë talent.
44. Mbetet në fund.
45. U vra me një grushgth nga Odiseu
47. Bëhet në start.
49. Catherine aktore.
50. Ishte babai i Odiseut

VERTIKAL

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një...FIAT.
3. Mbyllin një hark.
4. Eshhtë si sarkazmë.
5. Fillojnë ideologjinë.
6. Ushtrohet me cd false.
7. Në këtë moment.
8. King Cole i muzikës.
11. Janë si cilësi.
12. Fillojnë nazet.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. Janë binarët.
18. Nënkuptojnë edhe pranga.
19. Aktet pa kufij.
20. I takojnë fituesit.
21. Quinn aktor.
22. Pak inekzistente.
23. Fillojnë dobët.
24. Rrjeshtohen në kuvertë.
29. Eshhtë divorci.
32. Një pije piratësh.
33. Zanore për perime.
36. Një peshk i rëndë.
37. Enti amerikan i hapësirës.
38. Yll anglez.
40. Gripi paa ekstreme.
41. Tiran pa kufij.
46. Në hyrje të oazit.
48. Fillojnë ilustrimet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Marple a Agatha Christie.
4. Zanore për zulu.
6. Zyteti i Protogora-s.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Janë tek në kufij.
14. Benigni aktor.
16. Mund të jetë me mbret.
18. Gjysmë ndikim.
20. Një dru aromatik.
21. Teke trani.
23. Janë me numër të tilla ushtarake.
24. Nusja pa çifte.
25. Iglit te Lazio.
26. Një pjesë e sipërfaqes.
27. Një fjalë... para kohe
28. Janë mashtrime... me grim.
31. Duken të gjata në pritje.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Shkruhen për filma.
5. Janë malet ruse të tilla
6. Agjenci Botuese Lokale.
7. Një kontestues i viteve shatëtdhjetë.
8. Në krye të drejtuesve.
9. Eshhtë racë kombi.
10. Steiger aktor.
13. I vihen kalit.
15. Një britmë në corrida.
16. Një gjellë gratis.
17. Rolet pa zë.
19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
20. Një brejtës pylli.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për gol.
27. Janë maskarenj.
28. Tre në tetëdhjetë.
29. Emri i parë i Fassbinder.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë Organizata e skuadrave të Formula 1.
35. Mbyllin punimet.
37. Ndoch në kufij.
38. Një pëllhurë.
40. Pak tradicionale.
41. Një cigan.
43. Fillojnë lehtë.
45. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			5	9			8	
8	6	4					3	
1			6				7	4
		1		5	8	9	2	
	3		7		2		6	
7	8	9	4		5			
7	9			5				1
		3			6	5	2	
8			3	1				

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	9	3	8	1	6	2	5	4
4	8	5	9	2	3	6	7	1
1	2	6	5	4	7	9	8	3
2	4	7	3	6	1	5	9	8
3	5	9	7	8	4	1	6	2
8	6	1	2	5	9	3	4	7
9	1	2	4	7	5	8	3	6
5	7	8	6	3	2	4	1	9
6	3	4	1	9	8	7	2	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Shumë herë, paraja kushton shtrenjtë - Ralph Waldo Emerson
- Disa njerëz duket nuk e kuptojnë se duke komentuar dhe gjykuar të tjerët, tradhëtojnë karakterin e tyre të keq - Ralph Waldo Emerson
- Koha është mësuesi më i madh, por vret të gjithë nxënësit e tij - Ralph Waldo Emerson

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	19	5	6	4	6	6	1	4	1	7	D	E	N	A	N	C	U	E	S	I	T	C		
1	15		11	8	8	6		5	L	I	M	A	O	D	A	T	H			T	R	U	P	
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7		5	G	D	T	A	R	T	A	R	E	T	U	
6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8		K	A	M	E	R	I	E	R	E	T	U	
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7	13		K	O	R	I	B	A	N	T	E	T	S	R
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7	7	7		C	M	Z	A	N	O	R	I	T	A		
		13	3		8	13	9		12	1			O	L	A	G	A		O	N	B			
16		4	13		13	3		6	1	5	5	3	S	D	O	I	O	M	T	E	N	D	A	
1	6	3	1	13	7		17			9	4	8	T	I	N	K	A	I	A	R	I	A	N	
13		9	7		8	17	3	16	9	15	6	8	U	N	R	E	D	I	P	I	L	O		
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3	8		H	A	P	A	T	A	L	I	N	E	R	
17	15	3	6	3		4	3	15	7	1	17	3	I	S	P	O	T	G	A	Z	E	T	E	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	S	I	K	E	N	D	E	T		
T	R	U	P	N	M	K	Q	E	N	I		
A	P	A	R	T	I	A	K	E	E	M		
M	A	R	C	E	L	P	R	O	U	S	T	
A	J	A	D	R	I	E	N	R	U	B		
R	E	A	L	M	O	L	P	T	I	P	P	O
G	R	E	M	I	N	E	T	A	P	A	T	
D	U	E	L	L	E	T	I	H	E	R	A	
L	T	E	A	R	K	A	H	E	M	N		
E	L	H	A	N	E	S	O	R	E	A	I	
S	A	A	D	I	T	E	N	D	E	R	K	
I	E	R	A	T	A	P	A	P	A			

FJALËKRYQI (2)

M	I	Z	A	T	E	K	I	P	E	T		
P	A	R	T	M	E	T	A	M	I	T	A	
A	M	I	N	T	E	M	A	T	I	K	E	
K	I	S	K	O	M	U	N	T	I	A	R	E
E	A	D	R	A	L	E	T	E	P			
T	D	A	N	A	T	M	E	T				
A	K	O	M	A	S	T	A	F	E	T	A	T
T	A	M	I	L	P	I	R	A	T	I	E	
P	A	R	E	T	I	E	T	L	E	T		
G	O	T	T	I	N	A	A	D	E	T	I	
R	E	S	P	A	P	L	A	N	I			
A	N	T	I	P	A	T	I	K	E	I	K	E

Thënie të mençura

- Ndërgjegja i ngjan ujit të një shatrvani - Sigmund Freud
- Kur e shihni dikë që nuk buzëqesh, dhuroi ti një - Zig Ziglar
- Çdo gjë që na shqetëson mbi të tjerët na ndihmon të përmirësojmë veten - Carl Jung
- Nuk e di ku po shkoj. Por e di që jam në rrugën time - Carl Sagan

